

Arsyetimi dhe Përqasjet për një Edukim për Paqe

LIBRI I PARE

**Mësimi për ndalimin e luftës. Mësimi drejt
një kulture paqeje**

Arsyetimi dhe Përqasjet për një Edukim për Paqe

LIBRI 1

Letra e Mirëseardhjes.....

Hyrja.....

Kapitulli 1 Axfenda e Hagës për Paqe dhe Drejtësi.....

Kapitulli 2 Planveprimi Konceptual.....

Baza 1

Baza 2

Baza 3

Baza 4

Kapitulli 3 Qëllimet e Përgjithshme Mësimore.....

Baza 1

Baza 2

Baza 3

Baza 4

Kapitulli 4 Metodatat: Një Pedagogji e Përfshirjes Demokratike.....

Mirëseerdhët miq në versionin shqip të Mësimit për Ndalimin e Luftës: Mësimi Drejt një Kulture Paqeje!

Ju jeni pa dyshim njerëzit më të rëndësishëm në vendin tuaj sepse gjithë liderët, ndërmjetësit, doktorët, mësuesit dhe prindrit e së nesërme ndodhen në klasat tuaja sot.

Çfarë rasti unik për ti pregatitur ata që të përqafojnë një kulturë paqeje dhe të refuzojnë një kulturë dhune.

Çfarë sfide të madhe keni që ti prezantoni atyre vlerat e demokracisë, barazisë gjinore, dashurinë për ambjentin, respektin për të drejtat e njeriut dhe ligjin ndërkombëtar, dhe jo dhunën. Çfarë gëzimi do tju sjellë juve, dhe për studentët tuaj që do të marrin pjesë aktivisht, në mësimin e aftësive të ndërmjetësimin, ndarjes së informacionit, dhe planifikimit komunitar. Çfarë kohe kreative mund të jetë kjo në orët e muzikës, teatrit, kërcimit, dhe sporteve ashtu si edhe në programet akademike që të shprehen këto vlera dhe të vlerësohen ndryshimet tona.

Programi në Shqipëri, nën drejtimin e aftë të Elton Skëndajt dhe grupit të tij të punës, është pjesë e një partneriteti unik ndërmjet Departamentit për Çështjet e Çarmatimit të Kombeve të Bashkuara dhe Thirrjes së Hagës për Paqe, një organizatë e shoqërisë civile ndërkombëtare jo-fitimprurëse. Ky program beson se pas edukimit për heqjen e armëve të vogla nga komunitetet, edukimi për paqe dhe çarmatim duhet që të paraqitet për të mbështetur largimin e këtyre armëve dhe për të ndryshuar mentalitetin e të rinjve, që ata të mos duan të përdorin armë apo thika.

Ju jeni një nga katër vendet ku kjo ide po testohet. Pas dy vjetëve ne do të vlerësojmë se çfarë rezultatesh ka sjellë ky program në nivele të ndryshme në Kamboxhia, Peru, Niger si dhe në vendin tuaj në Shqipëri.

Mbështetje modeste financiare për këtë projekt ka ardhur nga Fondacioni i Kombeve të Bashkuara dhe nga qeveria gjermane. Thirrja e Hagës për Paqe ka një komunitet edukatorësh në të gjithë botën, prej të cilëve merr këshilla. Betty Burkes, Koordinatorja Jonë Pedagogjike, është vazhdimisht në kontakt me grupin e punës shqipëtar për te dhënë ndihmë dhe burime. Partnerët që punojnë në të katër vendet do të kenë mundësi të shkëmbejnë eksperiencën dhe ne do të shkëmbejmë rezultatet në mënyrë që njerëzit në vende të tjera të mund të mësojnë nga puna jonë.

Për të Arritur Paqen ne duhet të Mësojmë Paqen, Paqja nuk vjen me ADN-në tonë. Fëmijët tanë po rriten në një botë ku shumë qeveri besojnë se shpenzimet gjigande për armatime dhe ushtri mund të sigurojnë paqen. Ne jemi të rrethuar nga akte të dhunshme, si lufta e fundit në Irak, përhapja e sëmundjeve, terrorizmi, edhe rritja e madhe e

papunësisë dhe varfërisë janë forma të dhunës. Megjithatë, në një kohë kur njerëzit dhe vendet ndihen më të pasigurtë se kurdoherë tjetër, popullsitë e këtyre vendeve kërkojnë atë që njihet si “siguria njerëzore”, dhe fondet e tepërta që harxhohen për përgatitjen e luftës shpesh do të thotë që janë fonde që i mohohen programeve për shëndetësinë, edukimin, analfabetizmin, trajnimin për punësim etj.

Prandaj, një grup i përzier edukatorësh janë mbledhur bashkë nën ombrellën e Thirrjes së Hagës për Paqe për të zhvilluar një Fushatë Globale për Edukimin për Paqe. Kjo do të thotë që ne besojmë se nëse të rinjtë dhe edukatorët si në shkollë ashtu edhe në komunitet, mund të jenë pjesëmarrës në zhvillimin e kapaciteteve për tu përballur me sfidat e këtij shekulli të ri – sfidat e armëve të reja të shkatërrimit në masë, të konflikteve të armatosura mes njerëzve ashti si dhe mes shteteve, të dhunës për shkak të etnicitetit, fesë, gjinisë, statusit ekonomik, përkatësisë politike e moshës, dhe ne mund të përfytyrojmë gjeneratat e reja të njerëzve të përkushtuar për të zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore.

Ky manual është një fillim. Është menduar që të adaptohet në kushtet lokale në të cilat përdoret. Është i bazuar në 50 pikat e Axfordës së Hagës për Paqe dhe Drejtësi në Shekullin e 21^{te}, e cila na çon neve nga një Kulturë e Dhunës, e cila përkufizonte shekullin e kaluar, drejt një Kulture Paqeje e cila duhet të përkufizojë shekullin e ri përndryshe ne nuk do të kemi një tjetër shekull.

Komiteti ynë Ndërkombëtar i Këshillimit po krijon një strategji për ta çuar këtë Fushatë përpara në mënyrë që ministritë e edukimit në nivel kombëtar, dhe vendim-marrësit lokalë në nivelet lokale të mund të marrin në konsideratë adoptimin e teknikave dhe ideve të Fushatës në sistemet e tyre të edukimit.

Ne ju urojmë mirëseardhjen në program dhe mirëpresim idetë tuaja, sygjerimet për planet mësimore, apo çfarëdo lloj komenti që ju mund të keni për të përmirësuar këtë Fushatë.

Ne ju urojmë gjithë të mirat dhe shpresojmë që ju të kënaqeni me këtë eksperiencë dhe të ndjeheni të shpërblyer ndërsa punoni me të. Unë kam besim të madh se nëse ka ndonjë gjë që mund të ndihmojë për ta bërë këtë botë një vend më të sigurtë për fëmijët dhe nipërit e mbesat tona, kjo gjë është edukimi për paqe.

Ju faleminderit për përkushtimin dhe pjesëmarrjen.

Cora Weiss, Presidente
Thirrja e Hagës për Paqe

Qëllimet dhe Përdorimet e këtij Burimi

HYRJE

“Është koha për të krijuar kushtet në të cilat qëllimi kryesor i Kombeve të Bashkuara, ‘shpëtimi i gjenëratave të ardhshme nga dënimi i luftës’ mund të realizohet. Ky është qëllimi i Thirrjes së Hagës për Paqe .”

-Akhenda e Hagës, Preambula, f.2

Qëllimi i këtij Burimi të Edukimit për Paqen

Mësimi për ndalimin e luftës: Mësimi drejt një Kulture të Paqes është përgatitur si një mjet i edukimit mbi paqen që përballet drejtpërsëdrejti me detyrën kryesore të nxjerrjes në pah të një kulture për paqen, ndalimin e luftës. Ndalimi i luftës u përfaqëua si një qëllim i përbashkët i rreth 10.000 qytetarëve të botës në Konferencën për Shoqërinë Civile të organizuar nga Thirrja e Hagës për Paqe në Maj 1999 në Hollandë. Konferenca adoptoi një plan 50-hapësh për të sjellë paqen në shekullin e ri, *Akhenda e Hagës për Paqe dhe Drejtësi për Shekullin e 21-të* (këtu e më poshtë e quajtur Axhenda e Hagës). Njerëz nga një klasë e gjerë lëvizjesh për paqen, gjithë zonat e botës, dhe pikëpamje e kultura të ndryshme ranë njëzëri dakort se kërkesa rrënjësore për arritjen e qëllimeve të parashtruara në Axhendë ishte edukimi universal për paqe. Drejt arritjes së këtij qëllimi edukatorët e paqes të mbledhur në konferencë iniciuan Fushatën Globale për Edukimin mbi Paqen. Ky burim është menduar të paraprijë Fushatën duke prezantuar rininë me edukimin mbi paqen dhe duke prezantuar në fushën e edukimit për paqe, tashmë të krijuar, mundësitë e reja pedagogjike të prezantuara nga *Akhenda e Hagës*.

Mësimi për Ndalimin e Luftës qëndron në kontekst dhe është ndërtuar mbi zhvillimet thelbësore dhe pedagogjike në edukimin për paqe që evoloi në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të.

Këto zhvillime, ndërsa u zhvilluan në vende të ndryshme, morën disa karakteristika të përbashkëta. Shumë edukatorë të paqes u influencuan nga puna e të tjerëve që praktikonin edukimin për paqe në vende thelbësisht të ndryshme. Nëpërmjet rrjetëve dhe shkëmbimit brenda organizatave si Komisioni për Edukimin mbi Paqen i Shoqatës Ndërkombëtare të Kërkimeve për Paqe, Keshillit Botëror për Mësimdhënie dhe Programim, Edukatorëve Ndërkombëtar për Paqe, dhe Shkollave të Bashkuara të UNESCO, u rrit një lëvizje globale. Në shpresojmë që përdoruesit e këtij burimi do të eksplorojnë në disa prej të shumtave punë egzistuese mbi teorinë dhe praktikën e edukimit për paqe dhe do të shikojnë disa prej programeve që janë prodhuar. Ky burim nuk duhet nënkuptuar si një instruksion përfundimtar dhe i plotë në të tërë fushën e

edukimit për paqe. Ai ofron një trajtim. Sidoqoftë, për të mësuar më shumë mbi fushat më të gjera, neve kemi radhitur vepra domethënëse në fund të çdo kapitulli dhe ja kemi kushtuar Librin 3 burimeve dhe mjeteve për pjesëmarrje.

Ndërsa për disa kjo njësi për edukimin mbi paqen mund të shërbëje si një hyrje në këtë fushë, për shumicën do të shërbëjë si një horizont i ri për edukimin mbi paqen i ofruar nga Axhenda e Hagës. Qëllimi ynë nuk është edhe aq shumë që të shpjegojmë Axhendën e Hagës si të tillë, por të përdorim Axhendën e Hagës për të dhënë shembull e specifikuar disa praktika efektive të edukimit për paqe, ndërsa fokusohet në propozimet që ajo ofron. Ndonëse i bazuar në koncepte dhe qëllime specifike të Axhendës së Hagës, burimi përmbledh trajtimet gjithëpërmbajtëse mbi edukimin për paqe të prezantuara në dy dekadat e fundit të shekulli të 20-të, duke bashkuar trajtimet e shumëfishta që kanë përbërë këtë fushë; midis tyre zgjidhjen e konflikteve, edukimin për zhvillim, edukimin mbi të drejtat dhe edukimin për çarmatim. Ne përpiqemi të gjallërojmë trajtimin gjithëpërmbajtës me mundësi praktike për të mësuar vlerat, aftësitë dhe njohuritë që do të mundësojnë shpërbërjen e institucionit të luftës, duke e zëvendësuar me institucionë të krijuara për të arritur sigurinë njerëzore në një kulturë paqeje. **Axhenda e Hagës** jep disa rekomandime për ndryshime institucionale thelbësore që mund të jenë baza rrënjësore për mundësi të tilla mësimi.

Metodat, trajtimet dhe procedurat e paraqitura këtu janë menduar të kontribuojnë për qëllimet me të gjera të edukimit për paqen gjithëpërmbajtës, i ndjekur në programe të zgjedhura ose krijuara për të mësuar drejt qëllimeve të **Axhendës së Hagës**. Këto qëllime japin si horizontin konceptual ashtu edhe kriteret për zgjedhjen e përmbajtjes së këtij materiali. Në mënyrë që të tregohet se edukimi për paqen është bërë një lëvizje globale, ne kemi zgjedhur materiale nga vende dhe rajone të ndryshme të botës si njësi mësimore që synojnë të demonstrojnë mundësite për mësimin drejt ndalimit të luftës. Ne e dimë se informacionet e ofruara në këtë edicion fillestar nuk janë globalisht të balancuara. Shumica e materialeve që ne kemi momentalisht janë nga Amerika e Veriut dhe vende Anglisht-folëse. Në shpresojmë për një përfaqësim më të balancuar globalisht të edukimit për paqe në edicionin pasardhës.

Kush mund ta përdori këtë burim?

Mësimi për Ndalimin e Luftës është krijuar për tu përdorur në seksionet e trajnimit të drejtuara nga Fushata Globale e Edukimit për Paqe, nga mësuesit edukatorë dhe mësues shkollash tetë-vjeçare e të mesme. Mësuesit edukatorë mund ta adaptojnë atë në kurset që merren me metodat e edukimit, filozofinë dhe/ose themelet e edukimit dhe, sigurisht, në edukimin për paqe. Mësuesit e shkollave mund ta përdorin si një burim direkt të planeve të mësimit, por synimi kryesor i këtij burimi është të jap sygjerime që mësuesit të krijojnë mësimet e tyre. Në shpresojmë se ministritë

e edukimit dhe autoritete të tjera shkollore do ta përdorin këtë libër si një instrument për zbatimin e *Planit të Integruar të Veprimit për Edukimin mbi Paqen, të Drejtat e Njeriut dhe Demokracisë* të UNESCO. Formati në të cilin informacionet janë paraqitur në librin 2 synon të jap informacion thelbësor mbi njësitë mësimore dhe të shërbëjë si model për krijimin e planveprimeve.

Ky burim mund të përdoret gjithashtu në trajnime afatshkurtra për mësuesit të organizuar nga shkollat, autoritetet e arsimit dhe shoqatat e edukimit. Libri 3 përfshin modelin e një trajnimi workshop që mund të adaptohet me afate të gjata në edukim nëse zgjerohet me zgjedhjen e materialeve nga leximet e sygjera në fund të çdo kapitulli.

Fushata Globale e Edukimit për Paqe, siç përshkruhet në Kapitullin 1, mund të ndihmojë edukatorët në identifikimin e materialeve të tjera mësimore me rëndësi kulturore dhe në krijimin e trajnimeve për mësues. Ju lutem konsultohuni me faqen tonë web në adresën <http://www.haguepeace.org/> ose shkruani tek Hague Appeal for Peace, c/o IWTC, 777 United Nations Plaza, New York, New York 10017, U.S.A.

Si të përdoret ky burim

Mësimi për Ndalimin e Luftës është organizuar në 3 libra të ndërlidhur por të pamvarur, secili prej tyre ka një funksion të veçantë, gjë që i bën të përdorshëm si burime mësimor individuale. Të marrë së bashku, librat japin një hyrje të shkurtër në disa nga qëllimet dhe metodat e edukimit për paqe, një planveprimi konceptual të veçantë për edukimin për paqe për qytetarët e gjithë botës, shembuj mësimor për të bërë të aftë edukatorët që të fillojnë dhe të zhvillojnë më tutje programe në edukimin për paqe, dhe mjete për pjesëmarrje më të gjerë në Fushatën Globale të Edukimit për Paqe. Materialet e Librit 2 janë prezantuar në një formë që lehtëson zgjedhjen dhe dyfishimin në një formë të lehtë për mësuesit. Të gjitha njësitë mësimore mund të riprodhohen. Ne kërkojmë vetëm që autorët origjinalë dhe Fushata Globale për Edukimin për Paqe e Thirrjes së Hagës për Paqe të citohen si burime. Libri i dytë është i hapur jo vetëm për adaptime dhe ndryshime nga ndryshimet e mësuesve që e përdorin këtë burim, por edhe për kontributin e tyre për edicione të ardhshme. Ky edicion do të vazhdojë të zgjerohet nga njësi shtesë që do të bëhen të mundura nga Thirrja e Hagës për Paqe nëpërmjet postës ose në faqen e internetit. (Shikoni Librin 3 për këtë faqe dhe faqe të tjera interneti.)

Prandaj, ky është një burim shumëkëndësh që mund të përdoret sipas nevojave që ka edukatori fillestar në edukimin për paqe ose dikush që përpiket të mësojë trajtimet e reja metodologjike dhe konceptuale të ofruara nga *Axhenda e Hagës. Mësimi për Ndalimin e Luftës* do të ndihmojë veçanërisht ata edukatorë që kërkojnë të vendosin punën e tyre në një planveprim konceptual dhe zhvillimor. Ne presim që edukatorët mësimore mund ti shohin Kapitujt 1 dhe 2 mbi arsyetimin

dhe planveprimin të nevojshëm në kurset themelore dhe ato të filozofisë së edukimit; ndërsa ata që japin kurse në metodat e mësimdhënies mund të fokusohen në Kapitujt 3 dhe 4 mbi mësimi e qëllimeve dhe metodave të mësimi, trajnuesit mund të fokusohen tek Libri 3, që ofron drejtime dhe një model për workshop, mësuesit e shkollave mund të përqendrohen tek Libri 2 për shembuj leksionesh. Sidoqoftë ne nxisim gjithë përdoruesit që të studiojnë me kujdes Kapitullin e 2, që paraqet një planveprim edukimi për ndalimin e luftës që rrjedh nga *Axhenda e Hagës* dhe që sygjeron fortësisht që të gjithë mësuesit që përdorin këtë planveprim, të familjarizohen vetë me *Axhendën e Hagës*. (Libra xhepi janë të përfshira në këtë paketë, dhe sygjerohet që libra xhepi me Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut dhe me Kartën e Kombeve të Bashkuara të shikohen gjithashtu.) Vërtet, ne shpresojmë se shumica do të lexojë gjithë burimin dhe do të kuptojnë integrimin rrënjësor që një fokusim tematik i sjell edukimit për paqe gjithëpërfshirës, dhe do të bëhen pjesë e përpjekjes së Fushatës Globale për Edukimin për Paqe për ta bërë gjithë edukimin një instrument të paqes.

Sygjerime për Lexime

Për një veshtrim mbi zhvillimet në fushën e edukimit për paqe, një burim i shkëlqyer është:

- Robin Burns dhe Robert Aspeslagh, *Three Decades of Peace Education Around the World, (Tre Dekada të Edukimit për Paqe rreth Botës)*, Garland Publishing INC London, 1996.

Ky është një koleksion esesh nga edukatorë të paqes nga e gjithë bota që janë asociuar me Komisionin për Edukimin për Paqe të Shoqatës Ndërkombëtare për Kërkimet mbi Paqen (shikoni listën e organizatave në Librin 3). Komisioni u krijua në 1972 dhe vazhdon të shërbejë si një agjent që lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar në edukimin për paqe. Komisioni është një organizatë firmëtare e Fushatës Globale për Edukim për Paqe.

Një tjetër burimi i përgjithshëm i nevojshëm është:

Betty A. Reardon, "Peace Education, A Review and Projection". 2001 (Edukimi për Paqe, Një Rishikim dhe Projektim). Mund të gjendet si monografi nga "Preparedness for Peace", (Përgatitja për Paqe), Shkolla e Edukimit, Box 23501, S-200 45 Malmo, Suedi.

Axhenda e Hagës për Paqe
dhe Drejtësi në Shekullin e 21-të
Një mjet për Edukimin për Paqe

Kapitulli 1

“Në mënyrë që të luftohet kultura e dhunës e cila përçan shoqërinë tonë, gjeneratat e ardhshme meritojnë një edukim radikalisht të ndryshëm – një edukim që nuk i jep lavdi luftës por që edukon për paqe, jo-dhunë, dhe bashkëpunim ndërkombëtar”

■ Axhenda e Hagës, f.13

Fushata Globale për Edukimin për Paqe

Fushata Globale për Edukimin për Paqe lindi nga energjitë e shoqërisë civile të bashkuara në Konferencën e Thirrjes Së Hagës për Paqe në Hollandë në Maj 1999. Edukatorët e paqes që morën pjesë në këtë ngjarje historike, duke parë nevojën për një fazë të re në zhvillimin dhe shpërndarjen e edukimit për paqe nisën Fushatën si një përbërës integral të *Axhendës së Hagës për Paqe dhe Drejtësi në Shekullin e 21-të*. Duke qenë se sektorë të tjerë të shoqërisë civile e panë edukimin për paqe si thelbësor në përparimin e Axhendës së Hagës, edukatorët panë në lëvizjen e Thirrjes së Hagës për Paqe një arenë për një fazë të re e globale të edukimit për paqe, një që do të çonte në shekullin e 21-të themelet e kësaj fushe, të zhvilluara në nivel kombëtar e ndërkombëtar në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të.

Siç tregohet në Deklaratën thelbësore të Fushatës, edukatorët ranë dakort që:

Një kulturë paqeje do të arrihet kur qytetarët e botës të kuptojnë problemet globale; të kenë aftësitë të zgjidhin konfliktet në mënyrë konstruktive, të njohin dhe të jetojnë sipas standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, barazise gjinore dhe raciale; të vlerësojnë diversitetin kulturor; dhe të respektojnë integritetin e Tokës. Një mësim i tillë nuk mund të arrihet pa edukim për paqe ndërkombëtar, autosufiçient dhe sistematik. (Pjesë nga Deklarata e Fushatës së Thirrjes së Hagës për Paqe)

Shumë prej edukatorëve të paqes që iniciuan Fushatën ishin pjesëmarrës aktiv në lëvizjet ndërkombëtare për paqe që kishin frymëzuar dhe ndihmuar për të aftësuar arritjet e tyre dhe për të krijuar edukimin për paqe në institucionet dhe vendet e tyre. Një pjesë e këtyre përpjekjeve ishin ndërmarre dekada më parë, bile më përpara se deklarata e parë e veprimtimit të UNESCO për edukimin për paqe, *Rekomandime mbi Edukimin për Paqe dhe Mirëkuptim Ndërkombëtar* e vitit 1974 dhe *Edukimi në lidhje me të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore*. (Këto dokumenta mund të merren prej UNESCO.) Duke qenë mbrojtës të fortë të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe solidaritetit profesional, ata e sollën këtë element në këtë faze të re si një strategji kryesore të Fushatës, duke formuar personalisht bërthamën e një rrjeti global edukatorësh vazhdimisht në rritje për të përparuar qëllimet e Fushatës.

Qendrat e Edukimit për Paqe

Rrjeti i lartpërmendur tani shtrihet anembanë botës, duke ofruar shërbime për edukatorët nëpërmjet iniciativave si rrjeti i qendrave të edukimit të paqes që Fushata Globale po zhvillon, me qendra që operojnë ose që po planifikohen të hapen në gjithë rajonet e botës (Shikoni Librin 3 për një listë të qendrave).

QENDRAT KANË FUNKSIONË TË NDRYSHME QË PËRFSHIJNË

- ◆ Konsultimet me edukatorë që kërkojnë të krijojnë apo të përmirësojnë edukimin për paqe në institucionet e tyre respektivë;
- ◆ Workshope trajnimi për mësues dhe facilitatorë të edukimit jo-formal;
- ◆ Organizimin e përvitshëm të një Instituti Ndërkombëtar mbi Edukimin për Paqe, një eksperiencë mësimi intensive për edukatorë të rinj dhe për edukatorë me eksperiencë.;
- ◆ Mbledhja dhe katalogimi i programeve të edukimit për paqe;
- ◆ Rishikimi dhe rinovimi i rregullt i këtij burimi;
- ◆ Krijimi i vazhdueshëm i faqes së internetit në të cilën Thirrja e Hagës për Paqe vendos njësitë mësimore dhe materiale për të lehtësuar përpjekjet e pamvarura të edukatorëve individualë të paqes në edukimin për paqe.

Faqet e internetit

Njësi nga ky burim janë të paraqitura në faqjen internet të Fushatës, ashtu si edhe versione me të gjata të materialit mësimor të prezantuar në Librin 2 dhe njësi të tjera, për të kompletuar dhe zgjeruar mundësitë për të instruktuar drejt qëllimeve të parashtruara në Fushatë. Një listë e faqeve internet të dobishme për edukatorët e paqes është e prezantuar në Librin 3. Lexuesve ju kërkohet që të dërgojnë informacion për faqe të tjera të lidhura me punën në edukimin për paqe. Thirrja e Hagës për Paqe është duke zhvilluar një dosje programi në internet si pjesë e Fushatës Globale për Edukimin për Paqe. ***Informacione për programet, evenimentet, dhe burime të tjera të edukimit për paqe janë të prezantuara dhe të arritshme nëpërmjet faqes internet të Thirrjes së Hagës për Paqe : <http://www.haguepeace.org/>***

Një Trajtim Gjithëpërfshirës për Edukimin për Paqe anembanë botës për Shekullin e 21-të

Trajtimi i edukimit për paqe i paraqitur nga Qendrat nëpërmjet këtij burimi është përfshirës, shumë dimensional dhe i gjithanshëm në substancën e tij; i orientuar drejt procesit në metodologjinë e tij; dhe u menduar për tu integruar nëpërmjet shkollimit, me procedura mësimore dhe përmbajtje për të gjithë nivelet e klasat. Ne pohojmë se Axfenda e Hagës ofron vetëm një planveprim të veçantë për edukimin për paqe. Ajo nuk përfshin gjithë përmbajtjen që përfshin temat dhe format e shumta të praktikave bashkohore të edukimit për paqe. Sidoqoftë, ne i referohemi dhe përfshijmë shumë prej këtyre temave dhe formave në njësitë mësimore, referencat dhe leximet e sygjera, dhe në materialet mësimore që ne kemi krijuar, zgjedhur ose adaptuar në Librin 2.

Ne identifikojmë, si njësoj domethënëse për edukatorët e paqes, fusha të tjera përveç edukimit të drejtave të njeriut, edukimit për zhvillim, edukimit për çarmatim dhe edukimit multi-kulturor. Ndonëse të pa integruara në Axfendën e Hagës edukimi ambjentalist, etik dhe mbi vlerat do të përfshihen në një trajtim vertetësisht të gjerë. Ndërsa jo të gjitha çështjet që kanë dhënë shtysën për lindjen e këtyre formave të edukimit janë trajtuar drejtpërsëdrejti, ato janë të gjitha të zbatueshme në mësimin *për* zbatimin e Axfendës së Hagës por jo në mësimin *rreth* saj. Mësimi *për* Axfendën e Hagës do të hedhë themelet e mësimin *rreth* Axfendës së Hagës, apo rreth çdonjërit prej përmbajtjeve dhe problemeve të konsideruara në edukimin për paqe. Do të kultivonte vlerat dhe mënyrat që do të inspironin ata që studiojnë me këtë burim për të vënë në veprim aftësitë dhe njohuritë e marra në edukimin për paqe.

Në mbyllje të këtij kapitulli ne kemi rradhitur një numër burimesh që japin më shumë trajtime të detajuara për çfarë konsiderohet edukim për paqe gjithëpërfshirës, më tepër sesa ne kemi mundur të ofrojmë këtu. Sidoqoftë, ky burim i shkurtër synon që të fokusohet në një mjet praktik për të hedhur dritë dhe për të specifikuar çfarëdo trajtimi të edukimit për paqe, përpunimin e një planveprimi konceptual. Duke paraqitur Axfendën e Hagës si një planveprim konceptual të mundshëm rreth të cilit të zhvillohen programe për edukimin për paqe, ne shpresojmë që të ndihmojmë edukatorët të shohin se si planveprime të tilla paraqesin mjetet për të integruar dhe lidhur temat e ndryshme që përbëjnë subjektin material të edukimit për paqe së bashku me disa prej trajtimeve të përmendura më lart. Ne dëshirojmë të inkurajojmë kërkime nëpër planveprime të tjera dhe krijimin e planveprimeve të reja që u përshtaten veçanërisht kulturave dhe konteksteve mësimore të edukatorëve në vendet e tyre respektive.

Edukimi për Paqe si Themelor, Global dhe Kulturalisht Specifik

Ajo për të cilën të gjithë edukatorët e paqes bien dakort, pamvarësisht nga trajtimi që ata mund të ndërmarrin apo nga planveprimi që ata përdorin, është ideja se edukimi për paqe mund dhe duhet të përfshihet në programet e gjithë shkollave anembanë botës.

Ne gjithashtu bien dakort, se duhet të jetë një përbërës i projekteve të edukimit jo-formal dhe programeve të drejtuara në zhvillimin e komuniteteve dhe në fuqizimin e të rriturve të pashkolluar dhe atyre fëmijëve që nuk kanë mundësi të vazhdueshme për shkollim. *Mësimi për Ndalimin e Luftës*, sidoqoftë, është i drejtuar tek edukimi shkollor formal. Problemet që frymëzuan Axhendën e Hagës nuk duhen ripërsëritur këtu si një arsytim për edukimin për paqe anembanë botës. Kushtet e botës paraqesin fakte mjaftueshëm që drejtuesit dhe qytetarët e të gjithë kombeve kanë shumë për të mësuar për të qenë të aftë të kapërcejnë dhunën e luftës, padrejtësisë, dhe të të gjitha formave të tjera të dhunës që shumë pjesëtarë të familjes njerëzore provojnë çdo ditë.

Zgjidhja e problemeve sociale ka nevojë për edukim publik të qëllimshëm, që përfshin informacion rreth problemeve, zgjidhje të mundëshme, dhe veprime të nevojshme për të arritur në një zgjidhje. Nëse, siç presumohet nga principet e demokracisë të njohura nga gjithë bota, shtetasit do të përfshiheshin aktivisht në krijimin dhe ndjekjen e zgjidhjeve, atëherë e gjithë shoqëria duhet të edukohet për këtë qëllim. Qartësisht kështu është situata nga e cila lindin problemet e krijuara nga kultura e dhunës. Fushata Globale për Edukimin për Paqe u ngrit nga njohja e kësaj nevojë. Sidoqoftë, as njohja e kësaj nevojë mbarëbotërore, as inkuadrimi në një trajtim gjithëpërfshirës, tregojnë një pranim të një edukimi për paqe homogjen dhe standart për të gjithë kulturat dhe komunitetet. Fushata synon të inkurajojë varietetin e modeleve dhe përmbajtjes më të gjerë, të përshtatshme për moshat dhe kulturalisht të krijuar për edukimin për paqe. Ne besojmë se format e edukimit për paqe kaq të ndryshme kulturalisht dhe më pranë komunitetit jo vetëm i shërbejnë më mirë mësimi, por pasurojnë shumë të tërë fushën e edukimit për paqe, duke rritur mundësitë e prezantimit të edukimit për paqe në ambjentin e mësimi anembanë botës. Dhe ndërsa Fushata afron dhe prek masa më të gjera dhe rradhit me tepër edukatorë, Thirrja e Hagës për Paqe do të ofrojë në ripunime të këtij burimi si dhe në faqen internet një varietet akoma më të gjerë trajtimesh dhe programesh nga sa ne kemi ofruar këtu.

Ndërsa ne diskutojmë nevojën universale për edukim për paqe, ne nuk mbrojmë universalizimin dhe standartizimin e trajtimeve dhe përmbajtjes. Ne besojmë se edukimi për paqe në çfarëdo forme që merr duhet të jetë një pjesë themelore e procesit të integritit social në të cilin edukimi luan një rol madhor. Prandaj, ne propozojmë që të paktën në shkollimin formal edukimi për paqe

të planifikohet zhvillimisht dhe vazhdimisht nëpërmjet fazave të zhvillimit të fëmijëve, adoleshenteve dhe të rinjëve. Kështu, në kemi përfshirë në njësite mësimore të Librit 2 shembuj të procedurave mësimore për të gjitha moshat. Për të demonstruar disa nga mundësitë për shkrirjen e mësimin të paqes gjatë gjithë edukimit, në ofrojmë shembuj njësisht dhe aktivitetesh të adaptueshme për subjekte të ndryshme.

Qëllimi Shoqëror i Edukimit për Paqe:

Ndalimi i Luftës, Mospranimi i Dhunës, dhe Vendosija e Drejtësisë

Qëllimet kryesore shoqërore të edukimit për paqe që ne mbrojmë këtu janë eliminimi i padrejtësive sociale, heqja dorë nga dhuna, dhe ndalimi i luftës. Lufta dhe të gjithë format e dhunës janë të ndërlidhura, siç evidentohet nga kultura e dhunës që na rrethon. Lufta është institucioni themelor i sistemit të tanishëm të sigurisë globale, burimi nga i cili rrjedhin arsyetimet për dhe zakonet e dhunës të gjetura në kaq shumë aspekte të jetës.

Njohuritë, aftësitë, dhe, më e rëndësishmja, vlerat që kanë qenë në bërthamën e edukimit për paqe për pesë dekadat e kaluara janë ato të nevojshmet për të përballur sfidat dhe mundësitë e reja të paqes në shekullin e 21^{te}. Këto sfida dhe mundësi, ndërmjet problemesh të tjera, kanë nevojë për një edukim për paqe me fokus më intensiv në përdorimet praktike, politike dhe aftësitë e mos-përdorimit të dhunës dhe në detyrat institucionale të përfshira në ndalimin e luftës. Ekziston një besim i mbarëpërhapur se dhuna është e paevitueshme, shpesh e nevojshme, por ka shumë pak njohuri për alternativat e shumta përveç dhunës. Konfliktet e armatosura midis shteteve janë të shumta. Lufta akoma pranohet si një mjet i ligjshëm nëpërmjet të cilit shtetet mund të ndjekin dhe të mbrojnë interesat e tyre kombëtare. Është një institucion brenda sistemit të shteteve i bazuar në ligj, madje ndoshta i kontrolluar ligjërisht. Për shkak të faktit që shtetet mbajnë me ngulm të drejtën për të organizuar dhe për të përdorur forcat e armatosura, të tjerët, veçanërisht ata që kërkojnë të sfidojnë apo të marrin në duart e tyre fuqinë shtetërore, grumbullojnë armatime dhe krijojnë konflikte të armatosura.

Dështimi i shteteve për të kërkuar aktivisht alternativa të luftës, krijon vazhdimisht një besim në legjitimitetin dhe paevitueshmërinë e luftës. Lufta duhet trajtuar si një institucion dhe alternativat e saj duhen konsideruar në çdo edukim që kërkon të kontribuojë në një paqe botërore të qëndrueshme. Duhet që të njihet si një problem tepër kompleks që kërkon një edukim për zgjidhje komplekse.

Për të lehtësuar një pamje komplekse të luftës dhe konflikteve të armatosur, edukimi për paqe synon të zhvillojë një perspektivë globale mbi problemet dhe një kuptim të faktit se humanët janë

një specie e vetme. Edukatorët e paqes e kanë shprehur prej kohësh si rrënjësor për ndalimin e luftës nevojën e zhvillimit dhe mësimit të konceptit të interesit global dhe krijimin e një ndjenje të identitetit njerezor që do të kompletojë dhe zgjerojë identitetet kombëtare dhe etnike nëpërmjet të cilave ne formojmë besnikëritë dhe antarësimet tona kombëtare dhe ndërkombëtare. Ekziston një numër i madh strategjish të gatshme për edukatorët që kërkojnë të arrijnë këto qëllime të caktuara edukuese. Ajo që ne kërkojmë të arrijmë tani është një grup me gjerësi të njëjtë i materialeve dhe trajtimeve që do të merren me detyrën e ndryshimeve institucionale, kështu që nxënësit të mund të kuptojnë dhe të jenë politikisht të efektshëm në punën e vështirë të çarmatimit, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, paqebërjen dhe paqeruajtjen – të gjitha këto deri tani janë lënë të bëhen nga ekspertët, sepse paramendohen që të jenë shumë teknike për shtetasin e zakonshëm. *Axhenda e Hagës* dhe shumë prej propozimeve që e kanë paraprirë, të bëra për zvogëlimin dhe eliminimin e luftës, tregojnë se ky paramendim është i gabuar.

Të gjithë shtetasit duhet të jenë të edukuar për gjykimin dhe vlerësimin e mundësive dhe preferenca për alternativa të sistemeve globale të sigurisë. Çmisticimi i teknikaliteteve që kanë errësuar çështjet themelore të sigurisë globale në syrin e shtetasve në përgjithësi është një sfidë thelbësore në edukimin për ndalimin e luftës. Kështu, edukimi për paqe tani ka nevojë të merret me propozime praktike për çarmatimin dhe çmilitarizimin. Shoqërite mund të transformohen vetëm nëse shtetasit shohin mundësitë për transformim, nëse ata kuptojnë mekanizmat e ndryshimeve institucionale mbi të cilat ky transformim mund të ndërtohet. Aftësimi i nxënësve për të parë këto mundësi dhe për të kuptuar këto mekanizma është një përgjegjësi parësore në fushën e edukimit për paqe të shekullit të 21^{te}.

Axhenda e Hagës është një nga të paktat burime të tanishme për këtë formë të edukimit për paqe. Ajo ofron në një dokument një demonstrim të gjerë të rekomandimeve politike dhe institucionale që do të sjellin ndryshimet e nevojshme komplekse që do të bëjnë të mundur një transformim kulturor për një paqe të qëndrueshme. Kur studioni Axhendën e Hagës, duke e krahasuar atë me plane të tjera për parandalimin dhe zhdukjen e luftës që janë paraqitur që prej shekullit të tetëmbëdhjetë, duke e përmbushur me elemente nga metoda dhe materiale ekzistente të edukimit për paqe, edukatorët do të gjejnë përbërës të një programi për zhvillimin e ndryshimeve praktike në sistemin global të sigurisë, dhe gjithashtu një vizion të një shoqërie botërore të drejtë e paqësore ashtu siç ne e duam. Bashkarisht një besim vizionar dhe praktik në mundësinë e një kulture paqeje janë të nevojshëm për detyrën e zhdukjes së luftës. Ne ofrojmë planveprimin e parashtruar në kapitullin pasardhës si një mjet për të integruar vizionin e Konferencës së Shoqërisë Civile të Hagës me disa nga mundësitë praktike që përbëjnë programin e propozuar për të avancuar drejt vizionit.

Qëllimi dhe Synimi i Edukimit për Paqe

Dekadat e fundit kanë dëshmuar një rritje të interesit për të mundësuar shkollat në trajtimin e problemeve globale. Janë krijuar programe që hetojnë probleme të dhunës, luftës, dhe padrejtësive në të gjitha nivelet, nga lokalet deri tek globalet. Prandaj, një rrjet programesh në edukimin shumëkulturore, edukimin gjinor, edukimin zhvillimor, edukimin ndërfaqësor, edukimin mbi të drejtat e njeriut, edukimin mbi vlerat, zgjidhjen e konflikteve dhe mospërdorimin e dhunës janë tani të pranishme për çdo edukator paqej. Disa shembuj janë paraqitur në Librin 2. Ka gjithashtu një numër punimesh që trajtojnë filozofinë shoqërore, filozofinë edukative dhe metodologjinë mësimdhënëse të edukimit për paqe. Disa prej këtyre punëve janë të shënuara në fund të këtij kapitulli për edukatorë që kërkojnë një njohuri më të gjerë dhe një studim më të thellë të edukimit për paqe.

Po mendohet gjithnjë e më shumë se programet shkollore duhet të paraqesin mundësira për vlerësim real dhe të informuar mbi këto probleme globale, duke vënë theksin mbi alternativat pozitive dhe mundësitë e shumta për zgjidhjen e problemeve, kjo për të balancuar imazhet e shumta negative të një shkatërrimi të paevitueshëm global që të rinjtë e provojnë çdo ditë. Për të arritur ekuilibrin, ekziston nevoja për zhvillimin e kërkimeve kritike dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe për ushqimin e imagjinatës krijuese për të paraparë alternativat.

Një alternativë për një të ardhme paqësore përkufizohet jo vetëm me mungesën e armiqësive të hapura, apo paqes negative, por si një prani e proceseve dhe kushteve të paqebërjes që mund të sigurojnë një paqe të sigurt, pozitive, dhe që zgjat. Kjo nënkupton një gjendje mirëqenieje, një proces shoqëror dinamik në të cilin drejtësia, barazia, dhe respekti për të drejtat themelore të njeriut maksimizohen, dhe dhuna, si fizike ashtu edhe strukturale janë të minimizuara.

Edukimi përfshirës për paqe është i rrënjësor në pamjen e gjithanshme dhe dinamike të paqes dhe është haptazi i bazuar mbi vlerat. Dy nga vlerat thelbësore të edukimit për paqe janë mospërdorimi i dhunës dhe drejtësia shoqërore. Këto vlera qëndrojnë dhe përkufizohen përgjatë gjithë procesit të mësimit për paqe. Një vlerë si jodhuna është e manifestuar nëpërmjet vlerave të tjera si respekti për të drejtat e njeriut, liria, dhe besimi kurse drejtësia shoqërore realizohet nga vlera si barazia, përgjegjësi dhe solidariteti.

Edukimi për paqe, ashtu siç ne e trajtojmë, përfshin zhvillimin e vlerave të paqebërjes, aftësitë dhe njohurinë. Edukimi për paqe i vetëm nuk do të arrijë ndryshimet e nevojshme për paqe. Ai thjesht përgatit nxënësit për të arritur këto ndryshime. Ai synon zhvillimin e njohurisë së përgjegjësisë sociale dhe politike, duke i udhëzuar dhe sfiduar nxënësit për të zhvilluar

pikëpamjet e veta mbi problemet e paqes dhe drejtësisë. Ai jep kurajo për të eksploruar mundësitë për kontributin e tyre në zgjidhjen e problemeve dhe në arritjen e një kulture për paqe. Trajtimi i edukimit për paqe i shpallur në këtë burim vendos theksin mbi një dimension kritik, mbi stuktura pyetëse ekzistente, norma dhe vlera. Ne besojmë se nxënësit duhet të jenë të sensibilizuar për vlerat kombëtare dhe konkurruese të fshehura në mësimet “asnjëanëse” rreth çështjeve kritike. Zhvillimi i kapaciteteve kritike është thelbësor për të sfiduar strukturat e sistemit të luftës që Axhenda e Hagës synon të ndryshojë.

Ndërsa ne i njohim limitet e edukimit për paqe, ne kemi parë se ai ngre shpresën duke demonstruar se njerzit janë të aftë të marrin aftësitë e nevojshme dhe duke ndriçuar momente të mësimin krijues. Edukimi për paqe është i mundshëm, biles edhe në një kulturë dhune. Dhe vërtet, ne jemi të bindur se edukimi për paqe është si i nevojshëm ashtu edhe i arritshëm në një botë të dhunshme. Edukimi për paqe mund të ndihmojë për të dhënë frymëzimin e duhur dhe drejtimin për lëvizje përtej një kulture dhune për të parashikuar dhe për të punuar drejt një kulture paqeje.

Ne gjithashtu njohim se përballja e këtyre problemeve në shkollë ka qenë problematike, dhe shpesh nuk inkurajohet ose pengohet nga autoritetet edukative ose autoritete të tjera publike. Por kështu ka qenë çështja edhe me forma të tjera të edukimit kritik. Solidariteti ndërkombëtar që Fushata Globale për Edukimin për Paqe synon të ndërtojë mund të japi mbështetjen e duhur për të mbështetur lëvizjen përpara të kësaj rezistence, që është një manifestim i mungesës së kuptimit të sistemit të luftës, dhe të kulturës së dhunës që e ruan atë.

Bërja e paqes është detyrë e vazhdueshme e njerëzimit, një proces dinamik, jo një gjendje e palëvizshme. Ka nevojë për një proces edukimi dinamik dhe vazhdimisht të rinovueshëm. Ky burim, gjithashtu, është menduar si një mjet vazhdimisht i rinovueshëm për tu përballur me nevojat e ndryshme të mësimin për të arritur dhe mbajtur paqen. Ne i bëjmë thirrje të gjithë edukatorëve që të bëhen pjestarë të këtij procesi rinovimi dhe zhvillimi.

Sygjerime për Lexime:

- ◆ *The Hague Agenda for Peace and Justice in the 21st Century (Axhenda e Hagës për Paqe dhe Drejtësi në Shekullin e 21^{te})*. Thirrja e Hagës për Paqe , c/o IWTC, 777 UN Plaza, New York, New York 10017, 1999
- ◆ *An integrated framework of Action on Education for Peace, Human Rights and Democracy (Një Planveprim i Integruar mbi Edukimin për Paqe, të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë)*, UNESCO, Paris 7 place de Fontenoy, Paris 75700, France, 1994.
- ◆ *Peace Education (Edukimi për Paqe)*, Harris, Ian, USA: McFarland & Company, 1998.

- ◆ *Comprehensive Peace Education (Edukimi Gjithëpërfshirës për Paqe)*, Betty A. Reardon, Teachers College Press, New York, 1988
- ◆ *Recommendations on Education for Peace and International Understanding and Education concerning Human Rights and Fundamental Freedoms (Rekomandime mbi Edukimin për Paqe dhe Mirëkuptimin Ndërkombëtar dhe Edukimin mbi të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore)*, UNESCO, Paris, 1974.

PLANVEPRIMI KONCEPTUAL

KAPITULLI 2

“KJO AXHENDË E HAGËS për Paqe dhe Drejtësi në Shekullin e 21^{te} ka dalë nga një proces konsultimi intensiv dhe demokratik midis antarëve të Komiteteve Koordinuese dhe Organizative të Thirrjes së Hagës për Paqe , dhe qindra prej organizatave dhe individëve që kanë marrë pjesë aktive në procesin e Thirrjes së Hagës për Paqe . Kjo Axfordë përfaqëson ato që këto organizata të shoqërisë civile dhe këta shtetas konsiderojnë si disa nga sfidat me të mëdhaja me të cilat njerëzimi përballet ndërsa futet në një mijëvjeçar të ri.”

- ◆ Axforda e Hagës, Preambula, f.1

Kapitulli 2 Planveprimi Konceptual

Katër Bazat Konceptuale të Axfordës së Hagës

Fraza e faqes së mëparshme përshkruan një proces të veçantë të shoqërisë civile që ne besojmë se do të influencojë thellësisht në të ardhmen e edukimit për paqe. Ne besojmë se studentët në

shkollat e sotme duhet të jenë të përgatitur për të ndërmarrë një rol aktiv në një proces të tillë. Përbërja programore e shumicës së edukimeve për paqe ka ndryshuar nga ana konceptuale, bazuar në koncepte të lidhura me shkaqet dhe alternativat e luftës si dhe me pengesat dhe kushtet për paqe, duke përfshirë drejtësinë shoqërore, barazinë ekonomike dhe qëndrueshmërinë ekologjike. Këto koncepte janë përdorur si bërthama rreth të cilave janë organizuar përmbajtje njohurish, instruksione në aftësitë për paqebërje, për të zhvilluar vlera paqësore dhe për të aftësuar studentët që të ndërmarrin veprime paqësore. Duke filluar me këto bërthama konceptuale, trajtime të ndryshme të edukimit për paqe janë zhvilluar rreth planveprimeve të veçanta, duke dalë nga një sërë fushash në të cilat puna kërkimore është bërë: rendi botëror, çarmatim, zhvillimi, ambienti, gjinia, konflikti, dhe të drejtat e njeriut, ndërmjet të tjerash.


Për faktin se ne mbrojmë një trajtim gjithëpërfshirës të edukimit për paqe, ne kemi organizuar një planveprim konceptual të Mësimin për Ndalimin e Luftës rreth konceptit bazë të ndalimit të luftës dhe qëllimit tejkalues të arritjes së një kulture paqeje, dy temat qëndrore të Axhendës së Hagës. Këto dy tema japin një planveprimi të përgjithshëm në të cilin mund të integrohen të gjithë temat e kërkimit për paqe dhe temat e numëruara përpara si trajtimet e shumëfishta të edukimit për paqe. Këtu ne kemi zgjedhur një produkt të lëvizjes për paqe të shoqërisë civile sesa një fushë studimi akademike, duke besuar se ky është një shekull që kërkon veprim të vendosur për paqe, dhe edukimi për paqe duhet të orientohet edhe më shumë drejt veprimit, duke edukuar studentët për qytetari globale aktive dhe të përgjegjshme.

Për shkak se ne e shohim si mjaftueshëm të gjerë dhe përfshirëse, dhe që veçanërisht ofron një plan gjithëpërfshirës për veprimin për paqe, literalisht një axhendë veprimi e këtij shekulli, ne e shohim Axhendën e Hagës si një planveprim të nevojshëm për edukimin e qytetarisë globale aktive. Ajo jep koherencë konceptuale, ndërsa ofron mundësi instruktive për llojin e ndryshimeve që bëhen nga nxënësit e edukimit për paqe.

Ne kemi marrë katër bazat konceptuale mbi të cilat Axhenda e Hagës prezanton rekomandimet e saja si përbërës të planveprimit që ne ofrojmë dhe si një shtesë dhe përmbushje e planveprimeve të tjera të edukimit për paqe, të cilat kanë prodhuar një pjesë të mirë të pedagogjisë dhe të njëjësive mësimore të përfshira në Librin 2. Planveprimi konceptual i *Mësimi për Ndalimin e Luftës* përfshin: “Shkaqet rrënjësore të Luftës/ Kultura e Paqes”; “Ligji dhe Institucionet Ndërkombëtare, Humanitare dhe të Drejtave të Njeriut”; “Parandalimi, Zgjidhja dhe Transformimi i Konflikteve të dhunshme”; dhe “Çarmatimi dhe Siguria Njerëzore”; këto janë të katër bazat apo kategoritë e veprimit të propozuara nga Axhenda e Hagës. Planveprimi jep parametrat për përmbajtjen e bazës konceptuale dhe për një hetim në mësimin që do të aftësojë shoqëritë për të avancuar drejt qëllimeve të Axhendës së Hagës. Në fund të çdo seksioni, të organizuar sipas bazave të

lartpërmendura, ne rekomandojmë si lexime dokumente të Kombeve të Bashkuara që mund të ndriçojnë më tepër përmbajtjen e bazave dhe të demonstrojnë që çështjet e përfshira janë një shqetësim serioz global.

PLANVEPRIMI KONCEPTUAL



Shkaqet Rrënjësore të Luftës/Kultura e Paqes

Baza 1

“NE KEMI PËRQAFUAR imagjinatën morale dhe kurajon e nevojshme për të krijuar një kulturë paqeje të shekullit të 21^{te} dhe për të zhvilluar institucione kombëtare dhe ndërkombëtare që duhet të jenë garantuesit e paqes dhe drejtësisë në botë.”

Axhenda e Hagës, Preambula, f.3

Baza e parë e Axhendës së Hagës është inspiruar nga vizioni i një bote në cilën qëllimi Kombeve të Bashkuara, “ti shpëtojmë gjeneratat e ardhshme nga plaga e luftës” mund të realizohet. Kjo bazë përfaqëson konceptin e një kulture paqeje si një qëllim tejarritës që duhet të motivojë zgjidhjet për problemet të cilat kjo bazë veprimore trajton. Në nxjerrjen e hapave që çojnë drejt një kulture paqeje, ajo rradhit disa nga karakteristikat më kryesore të kulturës së dhunës: edukimit që i thur lavde dhe përgatit për luftë; globalizimin i cili ka zmadhuar hapësirën midis të pasurve dhe të varfërve; një ambient të dëmtuar nga mbi-konsumimi dhe shkatërrimet ushtarake; kolonializmin dhe neokolonializmin, mungesën e tolerancës racore, fetare, etnike, dhe

gjinore; diskriminimin kundrejt grave; abuzimin mbi fëmijët dhe të rinjtë; mungesën e demokracisë dhe qeverisjes së drejtë në gjithë botën; dhe dhunën kulturore, kolektive dhe lokale. Secili dhe të gjithë këto probleme janë domethënëse për edukimin e paqes.

Kjo bazë e planveprimit kërkon të aftësojë mësuesit të zhvillojnë midis studentëve të tyre një kuptim kritik të sistemit të luftës dhe të kulturës së dhunës që ajo përsërit në vazhdimësi. Gjithashtu jep mundësitë për të ushqyer kapacitetet krijuese të nxënësve për të imagjinuar një sistem ndërkombëtar që do të dedikohet paqes dhe drejtësisë botërore. Në këtë të parën nga të katër bazat e Axhendës së Hagës të cilat formojnë bërthamën konceptuale të *Mësimi e Ndalimit të Luftës*, koncepti i një kulture paqeje është prezantuar si një qëllimi i përgjithshëm i kërkuar nga lëvizjet e shoqërisë civile që u ndërthurën në Konferencën e Hagës të Shoqërisë Civile. Kjo bazë nxjerr një grup rekomandimesh të dala nga pengesa të veçanta që i kanë dalë kulturës së paqes të mbrojtur prej Axhendës së Hagës. Duke ftuar studentët të mendojnë dhe sygjerojnë strategjitë për të ndërmarrë këto hapa mund të krijohen mundësi për zhvillimin e imagjinatës krijuese dhe aftësitë e planifikimit të veprimit politik.

Për të filluar hetimi në format dhe mënyrat e mësimi që do të ishin më përçueset drejt një kulture paqeje, edukatorët kanë nevojë të kultivojnë një kuptim të “kulturës” si vlerat dhe pikëpamjet botërore që vendosin aspektet domethënëse të identitetit njerëzor, lidhjeve, zakoneve, dhe institucioneve, një dinamikë njerëzore që është gjithmonë në ndryshim e sipër. Kultura është një grup modelimesh, i rrënjësor në histori dhe i transmetuar nëpërmjet shoqërisë që përmbledh njohuritë e përbashkta, besimet dhe sjelljet e një grupi. Që edukimi është një kontribut madhor për kulturën, ashtu siç edhe kultura ndikon thellësisht tek edukimi, është e njohur dhe shpallur në rekomandimet e para të kësaj baze veprimore të Axhendës së Hagës që mbron “edukimin për paqe, të drejtat e njeriut dhe demokracinë.”

Studentëve duhet tu mësohet nëpërmjet shpjegimeve të këtyre dhe shkaqeve të tjera të luftës që të bëhen të aftë për të kuptuar se lufta nuk është një fenomen i izoluar. Lufta penetron mënyrën e të menduarit, pikëpamjet për botën, institucionet sociale dhe lidhjet njerëzore në të gjithë botën. **Axhenda e Hagës** identifikon këtë penetrim si “kultura e dhunës”. Në rekomandimet nga 1 deri në 11, ajo nxjerr në pah disa nga shfaqjet me të mëdhaja të kulturës së dhunës si shkaqe rrënjësore të luftës dhe vendos në dukje disa propozime për ti eliminuar ato si hapa drejt ndalimit të luftës, transformimi kryesor që nevojitet për të arritur në një kulturë paqeje.

Shkaqet Rrënjësore të Luftës: Siguria Kombëtare dhe Ndërkombëtare Ushtarakisht e Bazuar

Axhenda e Hagës identifikon pesë shkaqe të veçanta të luftës në botën e sotme: edukimin që i thur lavde luftës ndërsa dështon në dhënien e mësimit mbi alternativat e luftës; globalizimi nga lart-poshtë; përdorimet e paqëndrueshme dhe pabarabarta të burimeve mjedisore; kolonializmi dhe neokolonializmi (kolonializmi i ri) që mohon demokracinë; dhe diskriminimi dhe pabarazia si p.sh. mos-toleranca racore, etnike, fetare dhe gjinore. Mësuesit duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për këto probleme në mënyrë që të ndihmojnë studentët në konceptimin dhe kuptimin e tyre bashkë me shkaqe të tjera të luftës dhe padrejtësisë që atyre do t'u duhet të konsiderojnë në eksplorimin e kulturës së dhunës.

Mësuesit janë përbërësi më thelbësor në të tërë procesin e edukimit për paqe. Si lojtarët kryesorë të përgjegjshëm në klasat e tyre respektive, mësuesit mund të lehtësojnë dhe shpjegojnë ndërmjet studentëve të tyre një analizë kritike të sistemeve aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë. Ata mund të ndihmojnë nxënësit të vlerësojnë se si sistemi i tanishëm i sigurisë globale, i mbajtur ushtarakisht, forcon institucionin e luftës dhe promovon forma të tjera dhune, duke përfshirë ato kulturore, psikologjike, fizike dhe strukturore.

Edukuatorët mund të marrin shumë shembuj për të ilustruar thënien e hapjes së *Axhendës së Hagës*: “bota po del nga shekulli më i përgjakshëm e i ndezur nga luftrat në historinë e botës.” Shembulli te Modeli i Trajnimit të Mësuesit në Librin 3 është menduar të paraqesë një proces përgatitor për të aftësuar mësuesit në ndërmarrjen e edukimit për paqe.

Mësimi për ndalimin e luftës ka nevojë që edukimi të hetojë se si sistemi i militarizuar i sigurisë mbarëbotërore është i mbështetur nga zhvillimi, prodhimi, shpërndarja dhe përdorimi i vazhdueshëm i armatimeve tejet të sofistikuara, të cilat konsumojnë sasi tepër të mëdhaja të burimeve botërore. Pyetje duhet të shtrohen rreth faktit se si këto burime mund të ridrejtohen drejt respektimit dhe garantimit të të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore. “Dhuratat” e lëna nga kolonializmi dhe vazhdimësia a neokolonializmit që dhunon dhe shpërdoron me të pafuqishmit duhet që të shqyrtohen, bashkë me rolin e fuqive madhore industriale që synojnë të çojnë në vazhdimësi avantazhet ekonomike dhe politike që gëzojnë në sistemin e tanishëm ndërkombëtar. Ideologjitë e propaganduara për të mbështetur nacionalizmin agresiv, mos-tolerancën fetare, padrejtësinë racore, marxhinalizimin (lenien mënjane) kulturor, përjashtimin ekonomik dhe pabarazinë gjinore duhen sfiduar nga programe të drejtuara drejt mësimit për paqe, të drejtat e njeriut dhe demokracisë, të integruar në çdo klasë mësimore. Ne duhet të kuptojmë se edukimi, historikisht, është përdorur nga shtetet për të kultivuar pranimin e luftës dhe të sistemit të luftës.

Edukimi për paqe e sfidon këtë formë edukimi të nacionalizmit konkurrues që mbështet sistemin e luftës duke mbrojtur edukimin për një ndërkombëtarizim të përbashkët të kulturës së paqes.

Dhuna Strukturale: Përhapja pa Kufij e Kapitalit Global, Shpërndarja e Padrejtë e Burimeve, dhe Abuzimi Industrial i Natyrës dhe Mjedisit.

Procesi i çrrënjësjes së shkaqeve rrënjësore të luftës kërkon venien në pyetje të strukturës ekonomike botërore, e ashtuquajtura dhunë strukturale. Gjithashtu kërkon konceptimin dhe planifikimin e një ekonomie globale të transformuar, e krijuar për të kapërcyer dhunën strukturale të varfërisë së imponuar. Edukimi për paqe mund të ndihmojë studentët të hetojnë në përhapjen e kapitalizmit korporativ (nëpërmjet korporatave) në epokën e globalizimit, duke vlerësuar pasojat e tij mbi mirëqenien e më të shtypurve e të preکشëmve, marxhinalizimin e pjesës më të madhe të popullsisë së botës, dhe shpërndarjen e padrejtë e të pabarabartë të përfitimeve të pasurisë së përfituar nga teknologjia moderne. Nxënësit adoleshentë dhe të rinj duhet të ekzaminojnë pasojat që paqja, demokracia, drejtësia ekonomike dhe të drejtat e njeriut vuajnë nga monolet aktuale mbi teknologjinë dhe mund të veprojnë pasojat potenciale afatgjata të strukturave dhe dominimit korporativ mbi ekonominë botërore.

Pasojat ekologjike të kontrollit të korporatave mbi burimet natyrore që ndikojnë potencialin e vendeve më pak të zhvilluara për të arritur zhvillim të qëndrueshëm janë një tjetër zonë thelbësore vëzhgimi për individët e rinj. Studentët duhen sfiduar që të mendojnë rreth kërcënimit se lufta mund të fillojë si shkak i shpërndarjes së padrejtë të burimeve të kufizuara ujore, dhe rreth faktit se si krizat e borxheve dhe politikat e zhvillimit kombëtar të drejtuara nga kërkesat e tregut do të ndikojnë në mundësitë e realizimit të një dinjiteti njerëzor dhe të një qëndrueshmërie ambjentale e mjedisore planetare.

Fushata Globale për Edukimin për Paqe synon të lehtësojë zhvillimin e burimeve dhe metodave për t'i paraqitur studentët me mënyra të menduari rreth këtyre problemeve që u përshtaten moshës së nxënësve. Edhe në klasat më të ulta, studentët mund të mësojnë rreth shkaqeve të dhunës dhe konflikteve dhe mund të inkurajohen që të gjejnë alternativa për këtë. Që prej etapave të hershme të zhvillimit të një fëmije, nocioni i një tendence të paevitueshme drejt armiqësisë dhe dhunës mund të vendoset në pyetje. Ndërsa studentët piqen, atyre mund tu mësohet për ndarjen midis të pasurve e të varfërve, dhe mund tu mësohet të hetojnë se si dhe pse këto pabarazira zhvillohen, dhe se si ato mbështeten dhe intensifikohen. Studentët mund të sfidohen jo vetëm që të njohin padrejtësinë strukturale, dhe të përgatiten për të krijuar struktura alternative, por edhe që të

përfshihen në mënyrë aktive në realizimin e këtyre alternativave si qytetarë të përgjegjshëm të botës.

Padrejtësia Sociale: Abuzimi Racor, Fetar, Mos-Toleranca Gjinore dhe Abuzimi i Fëmijëve

Lufta dhe kultura e dhunës ka pasur pasoja shkatërruese brenda të gjitha shtresave të shoqërisë njerëzore; ato infektojnë dhe dhunojnë të gjitha aspektet e jetës. Pasojat e kulturës së luftës dhe dhunës janë të dukshme në jetën e përditshme tek pabarazia gjinore, padrejtësitë racore, diskriminimi në bazë të orientimit seksual, konfliktet ndërfaqetare, marrja në stukturat militare të fëmijëve ushtarë dhe forma të tjera të abuzimit të fëmijëve. Midis formave më vdekjeprurëse të dhunës janë luftrat brenda shteteve që vendosin përballë njëri-tjetrit grupe të ndryshme etnike. Shumë luftra janë të kuptueshme dhe shpjegueshme nga vetë ndryshueshmëritë njerëzore që edukimi për paqe ka identifikuar si një fuqi e njerëzimit dhe si pasurim i jetës njerëzore. Ndryshueshmëria kulturore dhe toleranca etnike e fetare janë vlera shoqërore kyçe të edukimit për paqe. Pjesa më e madhe e këtyre konflikteve të armatosura përfshijnë krime të tmerrshme gjinore në një shkallë që nuk ka precedentë, të ndërmarra sistematikisht si një strategji lufte. Shtypja e femrave, burrave homoseksualë dhe grave lesbike, që shpesh është e shprehur nëpërmjet dhunës, tanime njihet si një faktor domethënës në kulturën botërore të dhunës.

Është tek njohja e karakterit kriminal dhe panevojshmërisë së këtyre kushteve që përbëjnë periudhen “më të përgjakshme dhe më të ndezur nga luftrat” të historisë së njeriut atje ku fillon mësimi sistematik dhe i paramenduar i kulturës së paqes. *Axhenda e Hagës* reflekton këtë sferë të mësimin, jo vetëm në një apel për eliminimin e shkaqeve të këtyre formave të dhunës, por edhe në nxjerrjen e një mësimi të veçantë për rolin përbërës të drejtësisë gjinore në promovimin e kulturës së paqes.

Promovimi i drejtësisë gjinore është një prej zhvillimeve që Axhenda e Hagës vendos përpara si një gur kilometrik në rrugën për kulturën e paqes. Kjo futet ndërmjet një serie rekomandimesh që flasin veçanërisht për dimensionet humane dhe sociale me domethënëse për paqen. Rekomandime të tjera përfshijnë respektin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe rinisë, zhdukjen e neokolonializmit, njohjen gjyqësore ndërkombëtare për krimet e lidhura me urrejtjen, promovimin e demokracisë ndërkombëtare dhe qeverisjes së drejtë mbarëbotërore, shpalljen aktivisht të mospërdorimit të dhunës, eliminimin e dhunës kolektive në nivelin lokal, dhe bashkimin e të tëra feve botërore në procesin për të transformuar kulturën e dhunës në një kulturë paqeje. Këto janë dimensionet që

studentët mund të shohin në jetën e tyre dhe/ose në jetët e të tjerëve si ta në pjesë të tjera të botës. Ato ofrojnë tokë pjellore ku mund të mbillen farat e para të mësimin për paqe. Të kultivuarit e kësaj mundësie është përgjegjësia e edukatorëve që kërkojnë të edukojnë një ndryshim.

Sygjerime për Lexime

- ◆ *International Decade for a Culture of Peace and Non-Violence for the Children of the World, 2001-2010 (Dhjetëvjeçari Ndërkombëtar për një Kulturë Paqeje dhe Jodhune për Fëmijët e Botës. 2001-2010)*, Rezolute e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2001. Dokument i Kombeve të Bashkuara A/RES/55/47
- ◆ *Declaration and Programme of Action on a Culture of Peace (Deklaratë dhe Program Veprimi mbi një Kulturë Paqeje)*, Rezolutë numër 53/243 e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Tetor 1999.
- ◆ *Boulding, Elise. (2000) Cultures of Peace: The Hidden Side of Story (Kulturat e Paqes: Ana e Fshehtë e Historisë)*. Shtypshkronja e Universitetit të Sirakuzës SHBA.

Libri 1

Ligji dhe Institucionet Ndërkombëtare, Humanitare dhe të Drejtave të Njeriut

Baza 2

“Thirrja e Hagës synon të zhvillojë dhe promovojë aderimin e çdo shteti në ligjin ndërkombëtar dhe zbatimin e ligjit ndërkombëtar”

Axhenda e Hagës, “Temat”, f.5

Brenda planveprimit programor të Axhendës së Hagës, baza e Ligjit dhe Institucioneve Ndërkombëtare, Humanitare dhe të Drejtave të Njeriut paraqet bazën për instruktim në disa nga detyrat madhore institucionale dhe normative që nevojiten për zhdukjen e luftës. Axhenda e Hagës bën thirrje për një numër të veçantë reformash institucionale në sistemin ndërkombëtar që krijuesit e shohin si një kontribut në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe vendosjen e një sistemi të drejtë ligjor për të mbajtur një rend botëror paqësor. Prandaj, *Mësimi e Ndalimit të Luftës* duhet të jetë prezent edhe në kontributet e mundëshme të ligjit ndërkombëtar humanitar dhe të të drejtave të njeriut. Ne i shikojmë mësimet madhore që mund të dalin nga studimi i kësaj bazë të Axhendës së Hagës si njohuri dhe aftësi të nevojshme për të zhvilluar normat ligjore dhe për të kultivuar vlerat shoqërore të një kulture paqeje.

Një mësim i tillë thërret për një hetim të marrëdhënieve midis përgjegjësive, të drejtave dhe ligjit, në një anë, dhe institutit të luftës në anën tjetër, duke konsideruar pasojat e luftës për individët, shoqëritë, dhe për të gjithë planetin. Ne propozojmë eksperiencë edukimore të cilat eksplorojnë vlerat dhe principet e lidhura me të drejtat e njeriut dhe ligjin humanitar ndërkombëtar për të demonstruar se si edukimi mbi të drejtat e njeriut jep mjete për transformimin e sistemit të tanishëm të luftës dhe kulturës së dhunës në një kulture paqeje. Dhe në të vertetë, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është bazuar mbi premisën se, për të siguruar paqen, të drejtat e njeriut duhet që të mbrohen.

Fushata Globale për Edukimin për Paqe e Thirrjes së Hagës për Paqe përfshin qëllimet e parashtruara në *Planveprimin e Integruar mbi Edukimin për Paqe, të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë* të UNESCO (1994) sepse ajo paraqet një shprehje gjithëpërfshirëse duke treguar lidhjet integrale të edukimit për të drejtat e njeriut dhe demokracinë me edukimin për paqe. Njohuritë për ligjin humanitar dhe të të drejtave të njeriut, në veçanti të Deklaratës Universale dhe standarteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, janë thelbësore për gjithë edukimet mbi demokracinë, me rëndësi të veçante tek edukimi për qeverisje demokratike mbarëbotërore dhe pjesmarrjen në shoqërinë mbarëbotërore civile. Këto janë njohuritë më themelore që duhen komunikuar në edukimin qytetar për një rend botëror paqedashës dhe të drejtë.

Ne inkurajojmë mësuesit që të adresojnë premiset themelore të trupëzuara në nocionin e “ligjit” si një agjent për të krijuar rende shoqërore të drejta midis dhe ndërmjet njerëzve. Ligji ndërkombëtar, në veçanti, është institucion që merret përgjithësisht me sjelljet e shteteve dhe gjithashtu vepron mbi individët si subjekte të këtyre shteteve. Ligji ndërkombëtar është gjithashtu i fokusuar mbi mbajtjen e një rendi të drejtë shoqëror, dhe është i krijuar që të mbaj përgjegjës qeveritë, dhe në rastet e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, mban përgjegjës edhe individët. Edukatorët mund të eksplorojnë origjinat e sistemeve të ndryshme të ligjit dhe kontekstet në të cilat ato janë krijuar, se si vihen në zbatim, si dhe qëllimet shoqërore e politike të cilave ato u shërbejnë.

Primare për kërkimin në të drejtat e njeriut është pyetja rreth diferencave midis *dëshirave* dhe *nevojave*, dhe diskutimi mbi të drejtat e njeriut ndihmon në shpjegimin dhe ndërmjetësimin e këtyre diferencave. Subjekti i nevojave, kërkesave, dhe të drejtave është veçanërisht i përshtatshëm për nivelet elementare. Studentët e shkollave të mesme duhet të hetojnë të drejtat dhe tagrat, si dhe bazat mbi të cilat këto tagra duhet që të vendosen. Ata duhet që të shtyhen që të reflektojnë mbi lidhjet midis të drejtave të njeriut, përgjegjësive shoqërore të trupëzuara në dinjitetin njerëzor, dhe detyrimet ligjore të bazuara në ligjin humanitar dhe të të drejtave të njeriut. Ata duhet që të ndihmohen për të eksploruar dallimet midis ligjit ndërkombëtar humanitar dhe ligjit të të drejtave të njeriut, duke pyetur se si ata janë të ndryshëm dhe se si ata ndërthuren me njëri-tjetrin. Nxënësit gjithashtu mund të inkurajohen që të ekzaminojnë institucionet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare që paraqesin planveprime, si Kombet e Bashkuara, Gjyqi Ndërkombëtar i Drejtësisë në Hagë, tribunalët për krimet e luftës, si dhe të porsa miratuarën Gjykatën Ndërkombëtare Kriminale.

Edukimi i paqes për të drejtat e njeriut duhet që të konsiderojë lidhjet midis këtyre sistemeve ligjore, komuniteteve, dhe shtetasve individualë. MËSUESIT MUND TË NGRENË DISA PREJ PYETJEVE TË MËPOSHTME:

- ◆ **Kush është roli i ligjit në jetën tuaj? Çfarë roli luan ai në zgjidhjen e konflikteve dhe në arritjen e drejtësisë shoqërore në shoqërinë tonë? Si mund të përdoret ligji në betejën për paqe dhe drejtësi të shekullit të 21^{te}?**
- ◆ **Si mund të mësojnë studentët, dhe të inkurajojnë të tjerët, për të respektuar dhe njohur të drejtat e njeriut të të tjerëve?**
- ◆ **Si mund të përfitojë gjithkush nga një kuptim më i madh i ligjit, institucioneve ligjore, dhe koncepteve e standarteve të të drejtave të njeriut?**

Nëpërmjet këtij tipi hetimi, i zhvilluar përshtatshëmrisht në kontekste të ndryshme kulturore, studentët mund të ndihmohen që të kuptojnë rolin kryesor që ligji mund të luaj në zhdukjen e institucionit të luftës, dhe që të vlerësojnë nevojën themelore të realizimit të të drejtave të njeriut në arritjen dhe në mbajtjen e paqes.

Lufta në vetvete është një sulm sistematik mbi të drejtat e njeriut. Standarti i jetës pakësohet; mungesa e ushqimit dhe materialeve është e zakonshme; njerëzit janë të terrorizuar; liria është e minimizuar në lokalitetet ku ka luftë, dhe të drejtat njerëzore, sidomos ato të grave dhunohen sistematikisht. Programet e edukimit për paqe duhet që të hetojnë se si lufta zvogëlon dinjitetin njerëzor, pengon të drejtën për sigurimin e jetës dhe integritetit trupor, shkatërron sistemet ekologjike, dhe qëllimi i edukimit për paqe duhet që të jetë hetimi mbi faktin se si lufta zvogëlon dinjitetin njerëzor, pengon të drejtën për sigurimin e jetës dhe integritetit trupor, shkatërron sistemet ekologjike, dhe i çvleftëson vlerën jetës njerëzore. Për më tepër, efektet e luftës, konflikteve të armatosura, dhe prezencës afatgjatë të bazave ushtarake, mbi gratë, adoleshentët, dhe fëmijët janë të gjitha çështje që mund të adresohen nëpërmjet edukimit që lidhet me ligjin ndërkombëtar humanitar dhe të drejtat e njeriut. Nxënësit e shkollave të mesme, për shembull, mund të studiojnë traktatet e nënshkruara për qëndrimin e trupave të huaja dhe se si këto traktate ndikojnë mbi popullsinë pritëse.

Situata e fëmijëve të cilët kanë marrë pjesë në luftë si ushtarë-fëmijë, një shqetesim madhor për Axhendën e Hagës, jep gjithashtu një bazë për studimin e të drejtave të njeriut dhe ligjit humanitar që është i përshtatshëm për të rinjtë dhe adoleshentët. Për të tepër, ata fëmijë që janë detyruar të luftojnë në konflikte të armatosura kanë nevojë që të mësojnë se ky trajtim është një dhunim i të drejtave të tyre sipas ligjit ndërkombëtar. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve aplikohet për të gjithë fëmijët dhe mund të shërbëjë si një bazë mbi të cilën të mbrohen të drejtat e fëmijëve dhe të punohet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ushtarë si dhe fëmijëve të tjerë, keqas të abuzuar që vuajnë nga shfrytëzimi, deri edhe skllavëria, në kulturën mbarëbotërore të dhunës. Ne besojmë se të gjithë fëmijët duhet të mësojnë mbi Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve.

Në mësimin për zhdukjen e luftës, studentët duhet që të prezantohen me kontributet aktuale të të drejtave të njeriut dhe ligjit humanitar si kundërveprim dhe riparim i efekteve dhe metodave të luftës. Të konceptuarit e alternativave jo të dhunshme për konfliktin e armatosur si dhe mundësi të tjera për përmbushjen e të drejtave të njeriut janë përbërës tepër të rëndësishëm për

edukimin për paqe. Ne besojmë se të kuptuarit e principeve dhe funksioneve të ligjit ka një kontribut të madh për qëllimet e bazave të tjera të Axhendës së Hagës si zgjidhja pa dhunë e konflikteve, kultivimi i një kulture paqeje, si dhe zhvillimi i sigurisë njerëzore. Për shkak se ligji është ndërmjetësi kryesor nëpërmjet të cilit përgjegjshmëria për krimet e luftës mund të kërkoet, mësimi mbi institucionet e ligjit humanitar dhe të të drejtave të njeriut është një përgatitje për arritjen e drejtësisë shoqërore.

Në veçanti, programet mund të çojnë përpara studimin mbi procesin e vazhdueshëm për mirëfunksionimin e Gjykatës Ndërkombëtare Kriminale dhe mbi Statutin e Romës që e krijoi këtë gjykatë, ashtu si dhe impaktin që ky zhvillim ligjor do të ketë mbi sistemet kombëtare ligjore. Mësimi mbi gjykimet zyrtare mbi krimet e luftës që trajtojnë dhunimet e kryera në luftrat në Ruandë dhe ish-Jugosllavi, si dhe gjyqet e popullit mbi krimet e luftës si ai i Dhjetorit 2000 i quajtur Gjyqi Ndërkombëtar i Grave për Krimet e Luftës i mbajtur në Tokio që u mor me çështjen e “grave të rehatit”, që u skllavëruan seksualisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, do të kontribuonin për të sjellë një kuptim më të gjerë të dinjitetit njerëzor, të drejtave dhe drejtësisë. Gjithashtu, principet e Njrembergut, të ardhura nga Gjyqi i Njrembergut pas Luftës së Dytë Botërore dhe të afirmuara si ligj ndërkombëtar nga Kombet e Bashkuara; komisionet e vërtetësisë që kërkuan të hedhin dritë mbi abuzimet e regjimeve shtypëse në Amerikën Latine dhe Afrikën e Jugut; si dhe mënyrat se si ky ligj është ose mund të ishte zbatuar në të gjitha këto raste, paraqesin një rëndësi programatike në edukimin për qytetari mbarëbotërore.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i studimit të çështjeve të të drejtave të njeriut si këto që përmendëm është zhvillimi i një kuptimi më të gjerë mbi çfarë nënkuptohet me siguri njerëzore. Mësimi rreth procesit se si viktimat e dhunimeve të të drejtave të njeriut kërkojnë drejtësi është themelor për edukimin për paqe. Ndërsa të mbijetuarit japin dëshmitë e eksperiencave të tyre nëpërmjet procedurave ligjore të përmendura pak më lart, ata sfidojnë padënueshmërinë e autorëve, dhe shpesh stimulojnë e nxisin hetime të mëtejshme në krimet që ata kanë kaluar. Studimi si i përgjigjes ligjore për këto raste të dhunimit të të drejtave të njeriut dhe të procesit të shërimit shpesh të bashkangjitur me dhënien e dëshmimeve, apo pjesëmarrja në një “komision vërtetësie”, mund të rrisë njohurinë e nxënësve mbi kuptimin e sigurisë njerëzore siç është përpunuar në Bazën 4 të këtij kapitulli.

Më e rëndësishmja në të gjithë edukimin për qytetari mbarëbotërore është shpërndarja e njohurive rreth konventave dhe standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që janë krijuar për të mbojtur të drejtat e njeriut dhe për të parandaluar abuzimet si dhuna fizike e strukturale, që shpesh kontribuojnë në shkaqet rrënjësore të luftës. Edukimi mbi të drejtat e njeriut ka kohë që

është njohur si pjesë integrale e edukimit për paqe, dhe ka një grup të madh programesh që duan të sjellin studimin e të drejtave të njeriut në shkolla.

Një trajtim procesi është po aq i vlefshëm në edukimin për të drejtat e njeriut sa edhe në edukimin mbi përmbajtjen e bazave tjera të Axhendës së Hagës. Një proces i thjeshtë rradhitje që mund të jetë i dobishëm në mësimin e bazës për të drejtat e njeriut dhe ligjin humanitar është rradhitja e mëposhtme e mësimin të të drejtave të njeriut e adaptuar nga *Këmbanat e Lirisë*, një manual trajnimi i përgatitur për përdorim në Etiopi (mund të gjendet tek People's Movement for Human Rights Education (Lëvizja e Njerëzve për Edukimin e të Drejtave të Njeriut) në adresën, 349 West 111th Street, New York, New York 10025, USA). Ky manual identifikon fazat e shumta dhe kryesore të mësimin si:

- ◆ **Krijimi i respektit për dinjitetin dhe rregullat e barazisë.** Brenda planveprimit të *Mësimi për Ndalimin e Luftës*, kjo do të ishte një mësim thelbësor e bazik. Të gjitha të drejtat e njeriut janë të bazuara në nocionin e dinjitetit universal për të gjithë personat. Barazia dhe paaanëshmeria janë në rrënjë të ligjit të drejtë dhe efektiv në të gjitha nivelet, që nga ai komunitar deri tek ndërkombëtar.
- ◆ **Krijimi i lidhjeve ndërmjet të drejtave të njeriut dhe përgjegjësisë shoqërore.** Një shoqëri që pasqyron drejtësinë shoqërore, ashtu siç është menduar nga krijuesit e Axhendës së Hagës është një shoqëri në të cilën individët kuptojnë se realizimi i të drejtave të njeriut për të gjithë varet mbi marrjen aktive të përgjegjësisë nga e tërë shoqëria për të siguruar që të drejtat janë të mbrojtura dhe të përmbushura nga shteti dhe qytetarët e tjerë. Përgjegjshmëria shoqërore duhet të mësohet dhe të praktikohet. Kjo përgjegjësi gjithashtu mund të ushqehet nëpërmjet hetimit dhe veprimit në një proces vëzhgimi, vlerësimi dhe zbatimi të standarteve ligjore, dhe ndërmarrja e veprimeve për të përsosur ligjin në kërkim të drejtësisë dhe paqes.
- ◆ **Kërkimi për drejtësi; përdorimi i analizës.** Ky burim ndan një qëllim me edukimin për të drejtat e njeriut duke qenë se ne mbrojmë edukimin për fuqizim dhe veprim. Studentët kanë nevojë që të mësojnë të vlerësojnë drejtësinë, të analizojnë në mënyrë kritike situatat e padrejtësisë dhe potencialin e ligjit ndërkombëtar, standartet e të drejtave të njeriut, dhe institucionet ku ato mund të mbrohen. Dëshira dhe kapaciteti

për të kontribuar në mposhtjen e padrejtësive dhe dhunës janë ndërmjet attributeve të atyre që janë bërë qytetarë aktivë global, duke ndërmarrë veprime në lëvizjet që përbëjnë shoqërinë civile globale. Aftësimi i mësuesve për të ndihmuar studentët në zhvillimin e kësaj dëshire dhe kapaciteti është një prej qëllimeve të ***Mësimi për Ndalimin e Luftës***.

Secili prej rekomandimeve individuale në këtë bazë të Axhendës së Hagës mund të formojë themelin për hetime në mënyrat specifike me të cilat ligjet e ndryshme ndërkombëtare, standartet e të drejtave të njeriut, dhe institucionet mund të zbatohen në parandalimin, dhe përfundimisht në ndalimin e luftës. Një hetimi veçanërisht frytdhënës mund të fillohet duke ftuar nxënësit që të zhvillojnë propozime për zbatimin e rekomandimit 27 për të “vendosur luftën nën kontroll të demokratike”. Një hetim i bashkangjitur mund të bëhet gjithashtu në një propozim të ngjashëm për të siguruar realizimin e Artikullit 28 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNj), i cili thote së “kushdo ka të drejtë për një rend shoqëror e ndërkombëtar në të cilin të drejtat dhe liritë e vendosura në këtë Deklaratë mund të realizohen plotësisht.”

Studimi i DUDNj duhet të jetë një përbërës esencial dhe themelor i edukimit për paqe, sepse ajo është themeli i standarteve dhe mekanizmave më të fundit, si dhe institucioneve të ligjit universal të të drejtave të njeriut. DUDNj, së bashku me konventa dhe traktate të tjera që janë krijuar dhe adoptuar për të realizuar principet normative që ajo deklaron, janë burime të dobishme për të përshkruar dhe përcaktuar kushtet që do të krijonin një kulturë paqeje.

Sygjerime për Lexime:

- ◆ ***World Plan of Action on Education for Human Rights and Democracy***, (Plani Botëror i Veprimit për Edukimin e të Drejtave të Njeriut dhe Demokracisë), i adoptuar në Kongresin Ndërkombëtar mbi Edukimin për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, i organizuar nga UNESCO në Montreal, Kanada, Mars 1993.
- ◆ ***Vienna Declaration and Programme of Action*** (Deklarata e Vienës dhe Programi i Veprimit), i adoptuar në Konferencën Botërore mbi të Drejtat e Njeriut në Vjenë, Korrik 1993. Gjetet në internet në: <http://www.unhchr.ch/huridocda/huridoca.nsf>

- ◆ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/RES/48/127 mbi *Dekadën e Edukimit mbi të Drejtat e Njeriut*, që mund të gjendet në internet në faqen: <http://www.un.org/documents/ga/res/48/a48r127.htm>
- ◆ *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve; Konventa mbi Eleminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundrejt Grave*. Në internet në faqen: <http://www.unhchr.ch/html/intlinst.htm>

Kapitulli 2 Planveprimi Konceptual

Parandalimi, Zgjidhja dhe Transformimi i Konfliktëve të Dhunshme

Baza 3

“Shumë Shpesh, Konflikti i dhunshëm “zgjidhet” prej aktorëve të jashtëm me pak apo fare referim tek dëshirat e atyre që u duhet të jetojnë me këtë zgjidhje. Si rezultat, zgjidhja e arritur është shpesh jetëshkurtër. Nëse përpjekjet për të parandaluar, zgjidhur dhe transformuar konfliktin e dhunshëm duan të jenë efektive në terma afatgjatë, ato duhet të bazohen në pjesmarrjen e fuqishme të grupeve të shoqërisë civile lokale të përkushtuar për ndërtimin e paqes”

Axhenda e Hagës, “Rekomandimet”, f.33

Një nga qëllimet bazë të edukimit për paqe është që të nxisë mësimin që çon si në një përkushtim tek ndërtimi i paqes dhe tek kapacitetet për ta bërë këtë gjë të mundur. Mësimi për ta

trajtuar në mënyrë konstruktive konfliktin është një qëllim edukimor esencial i këtij planveprimi. Tradicionalisht, zgjidhja ka qenë në fokusin e përafrimeve edukimore për konfliktin. Me përdorimin e një trajtimi gjithëpërfshirës dhe i orientuar nga procesi, neve synojmë të zgjerojmë pamjen drejt një trajtimi më gjithëpërfshirës, konceptual e mësimor të konfliktit. Ne shikojmë tek procesi i konfliktit një rast për të mësuar dhe rritur duke lëvizur nëpër dhe midis si eksperiencave ashtu edhe shërimit nga konflikti. Ne përdorim frazën “proces konflikti” për të nënkuptuar një kuptim të konfliktit si faza të zhvillimit që përfshijnë shtresat në nevoja të ndërlidhura dhe të vazhdueshme, zakonesh dhe lidhjesh, ngjarjesh dhe veprimesh që ndodhin në fazat e lidhjes midis dhe ndërmjet palëve konfliktuese. Ky proces trajtimi gjithëpërfshirës për transformimin e konfliktit të dhunshëm është, sipas besimit tonë, më i përshtatshëm me trajtimin pjesëmarrës që mbrohet në Axhendën e Hagës, dhe me trajtimin gjithëpërfshirës për parandalimin, paqeruajtjen, ndërtimin e paqes të rekomanduar nga Sekretari i Kombeve të Bashkuara Boutros Boutros-Ghali në raportin e tij vjetor të 1993, *Një Axhendë për Paqe*.

Axhenda e Hagës identifikon tre faza të konfliktit: parandalimin, zgjidhjen dhe transformimin. Ne i kemi zgjeruar këto tre kategori si një vazhdimësi procesi e nën-koncepteve të mëposhtme apo fazave të procesit të konfliktit:

1. Paraprirja e konfliktit;
2. Analizimi i konfliktit;
3. Zgjidhja e problemeve
4. Trajtimi dhe manaxhimi i konfliktit përmes mekanizmave institucionale;
5. Zhvillimi i strategjive për ndryshim
6. Kërkimi i pajtimit; dhe
7. Ndërtimi i marrëdhënjeve pozitive

Çfarë ne kemi prezantuar këtu është një radhë e fazave dhe koncepteve të veçanta që nuk janë njëra pas tjetrës, por janë të ndërlidhura në një rrjet procesesh dhe lidhjesh të vazhdueshme dhe ndërvepruese. Prandaj, procesi i konfliktit është gjithmonë dinamik, i vazhdueshëm, dhe ekologjik, në kuptimin që, ashtu si sistemet e gjalla, konfliktet ndryshojnë në përputhje me kontekstin, faktorët e menjëhershëm apo afatgjatë, si dhe influenca të brendëshme e të jashtme. Ne besojmë se kjo pikëpamje për konfliktin mund të mundësojë nxënësit të manaxhojnë, drejtojnë dhe zgjidhin konfliktin, me qëllim që kushtet e mbas-konfliktit të mund të kontribuojnë në lidhjen pozitive të një kulture paqeje.

Një proverb i vjetër Kinëz thotë, “Atij që qellon i pari, i kanë mbaruar idetë.” Ky paramendim i përshtatet arsytimit tonë për edukimin si një trajtim fuqizues për parandalimin, zgjidhjen dhe transformimin e konflikteve të dhunshme dhe jo të dhunshme. Ne besojmë se vlerat, zakonet, aftësitë dhe njohuritë që mund të mësohen nëpërmjet këtij procesi trajtimi do të ndihmojnë për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për të krijuar mundësi alternative veprimi për ndërtimin e paqes. Besimi ynë mbështetet mbi katër paramendime thelbësore:

- ◆ **Konflikti është një pjesë normale dhe e paevitueshme e eksperiencës njerëzore;**
- ◆ **Ashtu siç kanë mësuar mënyrat e të qenit të dhunshëm, qeniet njerëzore dhe shoqëritë humane mund të mësojnë ta trajtojnë atë në mënyrë konstruktive;**
- ◆ **Ndërvarësia e të gjitha formave të jetës ka nevojë për lidhje ushqyese dhe të qëndrueshme për të mbrojtur të drejtat e njeriut, për të arritur sigurinë njerëzore, dhe për të siguruar mbijetesën e këtij planeti;**
- ◆ **Konflikti është shpesh një rezultat i nevojave të paplotësuara. Nëse këto nevoja paraprihen dhe manaxhohen në mënyrë pozitive dhe të drejtë, të ardhura që rrisin jetën mund të arrihen.**

Ne i përkufizojmë fazat e mëposhtme të konfliktit në lidhje me temat dhe qëllimet e Axhendës së Hagës dhe Axhendës së Hagës për Paqe. Temat dhe qëllimet, të prezantuar si rekomandimet e Axhendës së Hagës, parashtrihen në kllapa pas krijimit të çdo etape të procesit të konfliktit.

Paraprirja e Konfliktit (Parandalimi)

Paraprirja është si proces ashtu edhe aftësi. Ajo i kërkon atyre që duan të bëhen paqebërës që të jenë të ndjeshëm si ndaj prezencës ashtu edhe ndaj potencialit të dhunës dhe padrejtësisë, sidomos atyre formave që Axhenda e Hagës trajton në tre bazat e tjera. Kur shkaqet e konfliktit janë identifikuar që nga rrënjët e tyre, mundësitë për paralajmërim dhe përgjigje të shpejtë ngrihen ndjeshëm (Rekomandimi 30).

Analiza e Konfliktit (Parandalimi)

Procesi i analizimit të shkaqeve, çështjeve, interesave dhe shqetësimeve të palëve që janë gati të hyjnë në një konflikt mund të shërbëjë për të parandaluar konfliktin e dhunshëm nëpërmjet

masave të tilla si sanksionet konstruktive (Rekomandimi 32) dhe ndërhyrja humanitare (Rekomandimi 33).

Zgjidhja e Problemeve (Zgjidhje - Paqebërje)

Gjithë edukimi për zgjidhjen e konflikteve thotë se konflikti zgjidhet në mënyrën më efektive kur trajtohet si një problem i përbashkët i palëve të përfshira në të. Një proces konflikti konstruktiv do të çonte në rikufizimin e konfliktit në terma të tilla. Aftësitë e zgjidhjes së konfliktit janë të aplikueshme në të gjitha aspektet e edukimit për jetën, por ato janë absolutisht esenciale në trajtimin e konfliktit në mënyrë paqësore. Ashtu siç aftësitë për zgjidhjen e problemeve nxiten tek individët nëpërmjet edukimit, dhe fuqizimi i njerëzve të rinj (Rekomandimi 35), po ashtu, edhe komuniteti ndërkombëtar mund të ndërtojë kapacitete institucionale, lokale (Rekomandimi 28) rajonale (Rekomandimi 38) dhe globale.

Kur një konflikt është bërë i dhunshëm apo është gati të bëhet i tillë, masa paqeruajtje mund të ndërmerren për të mbajtur dhunën dhe/ose hequr kërcënimin e dhunës, dhe për të bërë të mundur për palet konfliktuale që të trajtojnë problemin e përbashkët.

Trajtimi dhe manaxhimi i konfliktit përmes mekanizmave institucionale

(Zgjidhje - Paqebërje)

Shtetasit duhet të jenë të familiarizuar dhe të jenë të aftë që të përdorin në mënyrën më të përshtatshme një sërë aftësish për zgjidhjen e konflikteve dhe mekanizmave institucionale që egzistojnë për zgjidhjen e konflikteve dhe për krijimin e kushteve për drejtësi, si ato që janë ofruar nga ligji ndërkombëtar dhe gjykatat aktuale ndërkombëtare.

Transformimi kërkon një proces të zgjidhjes së problemeve që bën të nevojshëm një ndryshim të lidhjeve dhe kushteve të dhunshme apo të padrejta që konflikti i dhunshëm krijon. Ky proces mund të ndodhë në një nivel personal, komunitar, shoqëror dhe/ose botëror. Në të gjitha kontekstet, përdorimi i mekanizmave institucionale në kërkimin e transformimit çon matanë fazës së zgjidhjes së procesit të konfliktit dhe ndryshon qëllimin e procesit nga marrëveshje afatshkurtër në ndryshim konstruktiv afatgjatë, dhe në disa raste, në ndryshime institucionale. Axhenda e Hagës e pranon këtë duke thirrur për barazi gjinore në ndërtimin e paqes (Rekomandimi 34) dhe duke mbrojtur të drejtën e njerëzve apo palëve të papërfaqësuara për vetëvendosje (Rekomandimi 36.) Gjithashtu ajo bën thirrje për forcim të mekanizmave të Kombeve të Bashkuara (Rekomandimi 29), dhe për aplikim të vazhdueshëm të shtetit ligjor, si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, me një fokus mbi ligjin humanitar dhe të të drejtave të njeriut.

Strategjite për zhvillim (Transformim - Paqebërje)

Transformimi i konfliktit është boshti i procesit. Ai përfshin jo vetëm ndryshimet në konflikt që përbëjnë zgjidhjen, por, në mënyrë më domethënëse, ndryshimet në vetë palët konfliktuese. Me transformim në nënkuptojmë një ndryshim të dukshëm në marrëdhënjet dhe perceptimet e palëve konfliktuese të cilat nëpërmjet fazës së zgjidhjes kanë arritur të shohin konfliktin si një problem të përbashkët dhe një mundësi për ndryshim konstruktiv me interes të përbashkët. Ky ndryshim vjen dhe afirmohet prej një përkushtimi për jo dhunën.

Pajtimi (Transformim – Ndërtim i Paqes)

Pajtimi qëndron në zemër të transformimit të konflikteve, duke bërë të mundur ndërtimin e kushteve të drejta dhe afatgjata paqeje mbi themelet e riintegritit të palëve të armiqësuar me njëra tjetren për shkak të një konflikti apo lufte. Ai përfaqëson rinovimin e marrëdhënjeve dhe shërimin e komuniteteve të prekura. Një proces pajtimi thërret për përfshirje komunitare dhe për mësim se si të pranohen dëmet e shkaktuara dhe të jepen dëmshpërblimet e riparimet. Ndërsa konflikti mund të zgjidhet nëpërmjet zgjidhjes së problemeve dhe mekanizmave institucional, pajtimi thërret për përfshirje ndërkomunitare të llojit që do të bëhej i mundur nëpërmjet forcimit të koalicioneve dhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile (Rekomandimi 37). Këto janë qëllimet e komisioneve të vërtetësisë dhe pajtimit dhe të projekteve të zhvillimit të përbashkët të rekomanduara në *Një Axhendë për Paqe*. Edukatorët e paqes duhet të ndërmarrin zhvillimin dhe mësimin e aftësive të pajtimit si esenciale për formën konstruktive të procesit të konfliktit që do të karakterizonte një kulturë të paqes.

Ndërtimi i Marrëdhënjeve Pozitive (Paqebërja – Krijimi i kushteve për siguri njerëzore dhe një Kulturë Paqeje)

Marrëdhënjet e drejta dhe pozitive janë esenca e kulturës së paqes. Ato janë qëllimet për të cilat paqebërësit luftojnë në situatat post-konfliktuale. Edukimi për paqe synon të ndriçojë domethënien e paqes për lidhjet ndërpersonale, ndërgrupore dhe ndër institucionale. Sepse është brenda këtyre marrëdhënjeve, dhe atje ku sundon demokracia e vërtetë, ku konflikti mund të drejtohet me qëllim që të prodhojë ndryshime sociale konstruktive. Përtej zgjidhjes dhe pajtimit, duhet që të ekzistojë rindërtim i drejtë, i cili ka nevojë për njohjen e plotë të pasojave të konfliktit të dhunshëm. Një trajtim i edukimit të paqes në mësimdhënien e historisë do të trupëzonte një dimension të tillë si një përbërës në pajtim dhe rindërtim, duke u mësuar studentëve të vlerësojnë

pasoja e konflikteve të kaluara dhe të tashme, dhe të hetojnë në mënyrat se si kjo të mos përsëritet më. Një trajtim i tillë mund ti ndihmojë studentët të mendojnë kushtet në të cilat do të eliminoreshin konfliktet e dhunshme dhe lufta nga shoqëria njerëzore.

Sygjerime për Lexime;

An Agenda for Peace, 1995 (Një Axford për Paqe): Me shtesën e re dhe dokumente të lidhura me këtë temë nga Kombet e Bashkuara, Edicioni i Dytë, nga Boutros Boutros Ghali, New York: Kombet e Bashkuara, 1995.

Conflict Resolution in Middle Schools: A Curriculum and Teaching Guide (Zgjidhja e Konflikteve në Shkollat e Mesme: Një Program dhe Drejtues Mësimdhënie), nga William J. Kreidler, Cambridge, MA: Edukatorët për Përgjegjshmërinë Shoqërore, 1994.

Libri 1

Çarmatimi dhe Siguria Njerëzore

Baza 4

“Është koha që të përkufizohet përsëri siguria në kontekstin e nevojave njerëzore dhe ekologjike në vend të sovraniteteve kombëtare dhe kufijëve kombëtare”

Axhenda e Hagës, “Temat”, f.4

Mësimet kryesore në lidhje me çarmatimin dhe sigurinë njerëzore janë ato që nevojiten për të shpërbërë institucionin e sistemit të luftës dhe për të arritur sigurinë e vërtetë njerëzore. Kjo bazë e Axfordës së Hagës merret më drejtpërdrejt me edukimin për të arritur ndryshime strukturale primare për zhdukjen e luftës. Siç është shënuar në Hyrjen e këtij burimi, edukimi për paqe duhet që të përballet tani me sfidën e të ndihmuarit të shtetasve që të planifikojnë dhe realizojnë detyrat esenciale të ndryshimit institucional në sistemin mbarëbotëror të sigurisë. Si të

gjitha bazat e tjera, edhe këtu është paqja si substancë e edukimit për procesin më të gjerë të transformimit kulturor. Procesi i ndryshimit të strukturave mund të konceptohet si çarmatim dhe çmilitarizim i sistemit të sigurisë. Por ka nevojë gjithashtu për çarmatimin e kodeve shoqërore të cilat kanë indoktrinuar sjelljet tipike konkurruese dhe agresive tek qeniet njerëzore. Ekzistojnë shumë mjete mësimore të drejtuara për të ulur agresivitetin, ndërsa kultivojnë simpatinë për të tjerët. Ekzistojnë gjithashtu, programe për të mësuar zgjidhjen konstruktive të konflikteve dhe për të rritur kapacitetet bashkëpunuese. Këto programe janë ndërmjet atyre që ne tregojmë për të mësuar edhe mbi çarmatimin dhe sigurinë njerëzore. Këto janë materiale për tu përkushtuar në procesin e mësimit të çarmatimit dhe çmilitarizimit e mendjes njerëzore dhe shoqërive njerëzore, procesi më i nevojshëm për zhdukjen e luftës. Edukimi në lidhje me këtë bazë i përket me shumë klasave të larta të shkollave të mesme, ndonëse disa nga kërkimet mund tu adaptohen klasave më të ulta¹. Ndërmjet qellimeve mësimore fillestare për tu ndjekur është rikonceptimi i sigurisë siç u tha edhe në kuotimin më lart. Shtetasit kanë nevojë të mësojnë që të shohin dhe të punojnë për një botë të çarmatosur, dhe që ta kuptojnë çarmatimin si një proces qëndror si në realizimin e vizionit të nevojshëm ashtu edhe në planifikimin dhe forcimin e institucioneve dhe strukturave alternative si zëvendësues për luftën dhe sigurimin e militarizuar. Nxënësit kanë nevojë që të venë re mënyra për të arritur vizionin nëpërmjet krijimit të një strategjie tranzicioni prej hapash të veçantë ashtu siç janë propozuar në “Veprimin Mbarëbotëror për Parandalimin e Luftës”, (Akhenda e Hagës, Veprimet Kryesore, f.10). Ky proces bën të nevojshme fazën të çmilitarizimit dhe çarmatimit, të prezantuar si grupi i parë i Rekomandimeve në bazën e katërt të Axhendës së Hagës. Këtij plani të përgjithësuar i shtohen edhe hapa të tjerë që mund të studiohen si një proces tranzicioni në një botë të çarmatosur. Hapat e sygjeruar si një listë detyrash për lëvizjen e shoqërisë civile për të zhdukur luftën janë një mënyrë praktike për të forcuar dhe për të çuar përpara fushatat ekzistuese dhe zhvillimin që çon drejt këtij qëllimi. Këto përfshijnë: uljen e shpenzimeve ushtarake, uljen e zhvillimit dhe shtimit të armëve, aderimin në traktatat e eliminimit të armëve, dhe mbajtja e shteteve përgjegjës për ndikimet ambientale të sigurisë ushtarake.

Analizimi i Sigurisë së Militarizuar

Kjo bazë ofron një bazament për të mësuar kuptimin e rreziqeve të sistemit të tanishëm, mundësitë për një sistem sigurie alternativ dhe të çarmatosur, dhe politikat e çarmatimit dhe ndryshimit. Mësuesit mund ta fillojnë këtë mësim me kërkime në karakteristikat dhe problemet e

¹ Kjo është veçanërisht e vërtetë për edukimin *rreth* çarmatimit. Edukimi *për* çarmatimin është në këtë planveprimi gjerësisht i ndjekur në klasat fillore dhe të mesme si edukim për të drejtat e njeriut dhe edukim për zgjidhje pa dhunë dhe kreative të konflikteve.

sistemit të tanishëm të sigurisë si një bazë për të kuptuar nevojën për alternativa. Disa pyetje bazike duhet të krijohen për kërkimin e menduar për tu dhënë nxënësve një pamje të brendshme në pasojat e sigurisë njerëzore të këtij sistemi shtetesh fuqimisht të armatosur. “Çfarë është”, mund të pyetet, “ajo që çon qeveritë të shpenzojnë miliona dollarë në armatime kur kaq shumë njerëz në botë nuk kanë së çfarë të hanë”. Pyetje të tilla provokuese mund të ndihmojnë për të futur studentët në një studim të harxhimeve ushtarake kundrejt atyre shoqërore; tregëtise së armatimeve, shpenzimet dhe efektet e mundëshme të armëve konvencionale dhe berthamore; pengesat për dhe mundësitë për çarmatim; si dhe sigurinë ekonomike e ekologjike si përbërës të sigurisë njerëzore. Çdo hetim drejton për tek mësimi thelbësor drejt arritjes së dhënies fund të dhunës së institucionalizuar ushtarake dhe ndalimit të luftës.

Një kërkim që mund të demonstrojë masën në të cilën armatimet nxisin aktivitetin ekonomik dhe ndikojnë jetët njerëzore mund të ndërtohet rreth pyetje të tilla si të mëposhtëmet:

- ◆ **Kush (cilat vende dhe prodhues) dizenojnë dhe prodhojnë armatime?**
- ◆ **Cilat palë i shesin dhe/ose i transferojnë ato në pjesë të tjera të botës?**
- ◆ **Kush i blen dhe i përdor ato dhe për çfarë qëllimi?**
- ◆ **Kundrejt kujt përdoren këto armë?**
- ◆ **Si shkatërrohen armët e dala nga përdorimi?**
- ◆ **Si kalojnë armët ushtarake në duart e civilëve dhe komuniteteve “në gjendje paqeje”?**

Studentët mund të konsiderojnë gjithashtu burimin e armëve të përdorura në faza të ndryshme të dhunës shoqërore, goditjeve me armë nëpër shkolla, vrasjeve, terrorizmit, dhe krimit.

Kërkimi diagnostifikues mund të ndiqet nga një tjetër që i drejton studentët për të konsideruar faktorët motivues për të eliminuar armatimet ushtarake, ndalimin e luftës, dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm paqeje të dizenuar për të vendosur theksin tek siguria njerëzore sesa tek siguria e shteteve në interes të të cileve funksionon sistemi i tanishëm. Mësuesit mund të ngrenë pyetje si disa prej këtyre të sygjera këtu:

- ◆ **Pse ti jepet një fund luftës?**

- ◆ Si do të ndikojë zhdukja e luftës tek mundësitë për ruajtjen e burimeve natyrore dhe ambjentit?
- ◆ Kush janë efektet e mundëshme të ndalimit të prodhimit të armëve dhe konflikteve të armatosura mbi ekonomite kombëtare dhe cilesinë e jetës njerëzore? Çfarë efektesh mund të priten në zhvillimin e shkencës?
- ◆ Çfarë çështjesh morale dhe etike duhet të konsiderohen kur kërkohet që tu hiqet e drejta shteteve që të përdorin forcën e armatimeve dhe armëve të shkatërrimit në masë në emër të interesit të tyre kombëtar?
- ◆ Si do të ndikojë çarmatimi dhe ndalimi i luftës tek jeta e fëmijëve, mundësive të tyre për të ndjekur shkolla, për të bërë miq, për të pasur ushqim mjaftueshëm, dhe për të mbajtur një libër në vend të një arme?
- ◆ Si mund të përmirësonte një përfundim i konflikteve të armatosura sigurinë njerëzore të grave, sigurinë e familjeve dhe integritetin trupor të vajzave të reja (që nuk do të abuzoheshin më si plaçka lufte, nuk do të përdhunoheshin më, apo nuk do të rrembëheshin më për të shërbyer si kuzhinierë, mbajtëse armësh, dhe skllave seksuale të forcave të armatosura)?
- ◆ A do të kishte përfitime të tjera për burrat që nuk do të detyroheshin me forcë të luftonin dhe të vdisnin për kauza dhe interesa për të cilat ata nuk kanë dijeni, apo mbi të cilat ata nuk kanë asnjë ndikim?
- ◆ Pse mundet që ju, të rinjtë që studioni këtë bazë të Axhendës së Hagës, të bashkoheni me të rinj të tjerë të botës që janë bërë aktivë në lëvizjen për çarmatimin botëror dhe ndalimin e luftës?

Planifikimi i një Bote të Çarmatosur

Kërkimi duhet gjithashtu të eksplorojë problemet dhe prospektet për çarmatim si një kërkesë kryesore institucionale për ndalimin e luftës.

Cilat janë çështjet dhe problemet që ndalojnë shtetet të konsiderojnë seriozisht ndarjen nga sistemi i sigurisë fuqimisht i armatosur për të cilin ata tani shpenzojnë kaq shumë nga pasuria kombëtare? Si mund të merren në konsideratë serioze nga shtetasit dhe bërësit e politikave mjetet jo të dhunshme të mbrojtjes? Nëse shtetet do të hiqnin dorë nga armët, si do të shkatërroheshin këto armë? Për çfarë ndryshimesh do të thërriste heqja dorë nga lufta? Çfarë ndryshimesh në

institucionet e qeverive kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare do të nevojiteshin nëse sistemi ndërkombëtar do të ishte me të vërtet një sistem paqeje? Si mund ti parashohin studentët këto institucione të transformuara? A mund të imagjinojnë ata një Ministri mbrojtje që dërgon paqeruajtës të paarmatosur, apo një sistem sigurie kombëtare që përdor ligjin dhe ndërmjetesimin në vend të forcës dhe frikësimit? Si mund të rritet mbrojtja dhe siguria nga koncepti i proceseve të konflikteve jo të dhunshme të paraqitura në bazën mbi transformimin e konflikteve? Si mund të rriten mbrojtja dhe politikat e sigurisë me përdorimin e standarteve dhe normave të ligjit ndërkombëtar humanitar dhe të të drejtave të njeriut? Njëpërmjet këtyre hetimeve, mësuesit do të jenë të aftë të paraqesin elemente të të katër bazave të Axhendës së Hagës në një shembull koherent ndryshimesh që mund të çojnë tek ndalimi i luftës, arritjes së sigurisë njerëzore dhe kultivimit të një kulture paqeje.

Koncepte dhe Trajtime të Sigurisë Njerëzore

Ndërsa Axhenda e Hagës nuk vendos përpara një përshkrim përfundimtar të sigurisë njerëzore apo një model gjithëpërfshirës për çarmatimin e përgjithshëm e komplet, ajo jep koncepte themelore dhe strategji praktike për të punuar drejt këtyre qëllimeve si shtylla të një kulture paqeje. Studimi i Axhendës së Hagës jep bazat për mësuesit për të kultivuar kuptimin e koncepteve individuale, lokale, rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë që nuk janë të varura nga ushtria apo nga armët bërthamore e armët konvencionale. Rekomandimet e saja mbi sigurinë ekonomike e ekologjike, të drejtat universale të njeriut, përdorimit të ligjit në vend të forcës fizike, formave të tjera të zgjidhjes jo të dhunshme të konflikteve, globalizimit nga poshtë-lart (demokratik), kalimit të shpenzimeve nga luftarake në paqësore, zhdukjes së armëve bërthamore, dhe krijimit të procesit të paqes paraqesin baza të qarta konceptuale mbi të cilat të përkufizohet se çfarë mund të quhet siguri njerëzore.

Axhenda e Hagës tregon se siguria njerëzore mund të realizohet më së miri kur të drejtat e njeriut janë siguruar, kur nevojat bazike njerëzore janë përmbushur, kur integriteti dhe vlerat e ambjentit natyror janë ruajtur, dhe kur mjetet alternative jo të dhunshme për trajtimin e konflikteve janë krijuar dhe përdorur vazhdimisht. Më tutje, ajo sygjeron mundësinë e një bote në të cilën nevoja e tanishme dhe zmadhimi i armëve shkatërruese, do të duket e paarsyeshme, e palogjikshme, dhe e padobishme kur shtetet e botës të bashkëpunojnë në interes të sigurisë së përbashkët në vend që të konkurojnë dhe të dominojnë në emër të sigurisë ekskluzive kombëtare. Një sens i tillë komuniteti mbarëbotëror dhe sigurie të përbashkët njerëzore mund të jetë ushqyesi më i madh i mundshëm për të ngopur mundësitë për një kulturë paqeje dhe drejtësie në shekullin e 21^{tes}. Nëse

edukimi do të ishte i devotshëm në zhvillimin e këtij drejtimi, ai do të jepte kontributin që ne shpresojmë të inkurajojmë dhe lehtësojmë me anë të këtij burimi.

Konkluzion

Ne besojmë së ky planveprim, i ofruar nga të katër bazat e Axfordës së Hagës, paraqet një bazë të qartë dhe koherente nëpërmjet së ciles të komunikohen pjesë domethënëse të edukimit ekzistues për paqe, dhe të drejtohet puna në ndërmarrjen e sfidave të ndritura nga urgjenca politike të arritjes në një paqe të drejtë e të qëndrueshme për këtë shekull dhe për të ardhmen.

Sygjerime për Lexime:

- ◆ *United Nations Study on Disarmament and Non-proliferation Education, (Studim I Kombeve të Bashkuara për Edukimin mbi Çarmatimin dhe Mos-prodhimin e armëve)*, New York: Kombet e Bashkuara, 2000, Dokument i KB: A/RES/55/33E. I gjetshëm në internet në faqen: <http://www.un.org/documents/ga/res/55/a55r033.pdf>
- ◆ *Disarmament Forum (Forumi i Çarmatimit)*, Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çarmatimit, Gjenevë, 2000. Edicion special për Edukimin për Çarmatim, 2000.
- ◆ *Hague Axhenda for Peace and Justice for the 21st Century (Axhenda e Hagës për Paqe e Drejtësi për Shekullin e 21^{te})*, Thirtja e Hagës për Paqe, 1999. Reference e KB A/54/98

QËLLIMET E PËRGJITHSHME MËSIMORE PËR EDUKIMIN PËR PAQE

KAPITULLI 3

“AXHENDA E HAGËS për Paqe ka nisur një fushatë mbarëbotërore për të fuqizuar njërzit në të gjitha nivelet me aftësitë paqebërëse të ndërmjetsimit, transformimit të konflikteve, ndërtimit të konsensusit dhe ndryshimet sociale jo të dhunshme.”

◆ Axhenda e Hagës, f.13

Kapitulli 3 Qëllimet e Përgjithshme Mësimore

Qëllimet mësimore tejshkuese të parashtruara në thënien nga Axhenda e Hagës të cituar pak më lart do të arrihen vetëm nëpërmjet një trajtimi gjithëpërfshirës të edukimit për paqe. Këto qëllime shoqërore e politike kanë nevojë për një grup aftësish paqebërëse brenda kontekstit të njohurive esenciale për paqe, të vlerave themelore të paqes dhe aftësi paqebërëse të rëndësishme. Qëllimet mësimore që do të diskutohen më poshtë janë nxjerrë dhe adoptuar nga fusha e gjerë e edukimit gjithëpërfshirës për paqe. Në grafikët dhe tabelat që dalin në këtë kapitull, ne prezantojmë disa prej tyre në format e tyre origjinale për të ilustruar se si planveprimi i Axhendës së Hagës mund të jetë një pikë hyrje në fushën me të gjerë. Ne sygjerojmë që lexuesit e këtij burimi gjithashtu të konsultohen me burimet origjinale të qëllimeve dhe planveprimit që ne kemi adoptuar në *Mësimi për Ndalimin e Luftës*.

Si gjithë edukimi për paqe, qëllimet e cituara këtu janë vlera të bazuara dhe drejtuara tek zhvillimi i një individi human ashtu si dhe një shtetasi të përgjegjshëm. Tabela # 1 është një nga prezantimet e një grupi vlerash themelore të trupëzuara në edukimin për qytetari mbarëbotërore njerëzore dhe të përgjegjshme.

Synimet Shoqërore dhe Qëllimet Edukimore

Në këtë kapitull ne do të përshkruajme disa qëllime mësimore brenda sferës së bazave në të cilat ato kanë rëndësi të veçantë. Ne duam, sidoqoftë, të tregojmë se të gjitha këto qëllime janë të ndërlidhura dhe në shumë pika janë plotësisht të transferueshme në mësimin dhe veprimin në bazat e tjera. Po kështu, planveprimet, ashtu si dhe qëllimet, të formuluar nga trajtime të tjera të edukimit për paqe, janë të rëndësishme për mësimin për të arritur qëllimet e parashtruara. Edukimi gjithëpërfshirës për paqe, për shkak se është përgjithësues, vendos theksin në ndërlidhjet

midis problemeve, duke favorizuar një orientim të procesit brenda trajtimit zhvillues. Ashtu si me gjithë edukimet e lidhura me një problem, të bazuar mbi vlera, qëllimet rrjedhin drejtpërsëdrejti nga problemi apo problemet qëndrore. Po kështu, shumica e metodave të sygjera në Kapitullin 4 dhe në shembujt programore të prezantuar në çdo bazë tek Libri 2 janë gati për tu adaptuar për bazat e tjera. Dhe, ashtu si qëllimet e tjera, metodat mësimore lidhen me problemet mbarëbotërore si dhe me njohuritë, aftësitë dhe vlerat që duhen zhvilluar.

Ne i kemi vendosur qëllimet e zgjedhura brenda konceptit të një planveprimi konceptual të ofruar nga Axfenda e Hagës, për të treguar që ne e njohim nevojën për njohuritë dhe aftësitë e veçanta për të arritur synimin specifik të kësaj baze, dhe për të ofruar aq synime sa të jetë e mundur nga ato që janë në fushën e gjerë të edukimit për paqe. Ashtu si me zonat e tjera të edukimit për paqe të trajtuar në *Mësimin për Ndalimin e Luftës*, ne u rekomandojmë atyre që kërkojnë njohuri më të gjerë të fushës të synimeve dhe objektivave që të shohin synimet e parashtruara në disa nga punimet standarte në këtë fushë të rradhitura në fund të çdo kapitulli.

Edukimi për paqe në të gjitha format e tij është përgjithësisht i konceptuar dhe planifikuar në terma qëllimesh shoqërore qëndrore, tejrritëse, dhe të bazuara në vlera. Ekzistojnë lidhje substanciale domethënëse midis këtyre vlerave, ashtu siç ekzistojnë këto lidhje ndërmjet problemeve globale që qëndrojnë si pengesa për realizimin e tyre. Një trajtim përgjithësues e gjithëpërfshirës vendos theksin mbi këto marrëdhënie në zgjedhjen dhe formulimin e përmbajtjes. Tabela #2, që rradhiti përmbajtje që i përshtaten edukimit të të drejtave të njeriut të konceptuar rreth synimit qëndror të arritjes së dinjitetit human universal nëpërmjet realizimit të të drejtave të njeriut, demonstroi dy dimensione përgjithësuese që mund të rrjedhin nga një trajtim gjithëpërfshirës: së pari, marrëdhënien midis dinjitetit njerëzor dhe ndalimit të luftës si një lidhje përbërëse midis drejtësisë dhe paqes (instituti i luftës është plotësisht i papërputhshëm me vlerën e dinjitetit njerëzor); dhe së dyti, adaptueshmëria e temave thelbësore të Axfendës së Hagës me përmbajtjen e përgjithshme të edukimit për paqe të bazuar mbi zhvillueshmërinë. Në këtë version të tabelës, temat e Axfendës së Hagës, u janë venë numrat (1-8) dhe janë zëvendësuar me çështjet dhe problemet e të drejtave të njeriut të mbrojtura për tu përfshirë në programin zhvillimor në tabelën origjinale, duke synuar të ndriçohen mësimet për arritjen e dinjitetit njerëzor. (Disa mësuës me interes të veçantë në të drejtat e njeriut si një trajtim i edukimit për paqe mund të dëshirojnë të konsultojnë burimet origjinale të cituara, ashtu si edhe versionin origjinal që duket këtu si Tabela # 5.) Ndërsa shikoni Tabelën # 2 dhe reflektoni mbi kapacitetet mësimore të përshtatshme për çdo fazë të zhvillimit intelektual dhe shoqëror të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve, ju do të shihni së temat, të prezantuara në një formë të përshtatshme programore, mund të

prezantohen në këdo prej niveleve zhvillimore. Edhe fëmijët më të vegjël mund të kuptojnë se është me mirë për të gjithë në komunitetin e tyre mësimor që të ruhen rregullat e drejtësisë sesa të arrihet tek kokëfortësia dhe luftimi (Tema 1: Ligj në vend të forcës). Fëmijët pak më të rritur mund të fillojnë të mësojnë vlerat etike që qëndrojnë në principet e të drejtave universale të njeriut (Tema 2: Të gjithë të drejtat e njeriut për të gjithë) dhe detyrimet e shoqërisë për të zbatuar burime për përmbushjen e nevojave njerëzore sesa për qëllimet shkatërruese të përgatitjes për, dhe luftimit të luftës. (Tema 3: Gjetja e parave për paqe). Në adoleshencë, kur të rinjtë fillojnë të futen më tepër në botën sociale, ata mund të ndihmohen që të reflektojnë mbi domethënien dhe pengesat për një siguri njerëzore të vërtetë (Tema 4: Siguria Njerëzore). Ata mund të fillojnë të studiojnë problemet e dhunës në botë dhe të kuptojnë dhunën strukturore si përbërës të globalizimit të kapitalit (Tema 5 Globalizim nga poshtë-lart).

Ata që lenë adoleshencën dhe janë duke hyrë në rininë e vonë mund dhe duhet që të përfshihen në format e edukimit civil që i bënë ata të aftë të marrin pozicionet dhe veprimet për të ndryshuar problemet e krijuara nga dështimi i diplomacisë tradicionale dhe nga sistemi i tanishëm i sigurisë ndërkombëtare (Tema 6: Dështimi i traditës). Ata mund të eksplorojnë mundësitë alternative për tu përballur me krizat mbarëbotrore, për të vlerësuar nevojën dhe efektivitetin potencial të ndërhyrjes humanitare (Tema 7: Ndërhyrja humanitare). Dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, ata mund të përfshihen aktivisht në mësimin e qytetarisë globale nëpërmjet pjesëmarrjes në një lëvizje apo organizatë të shoqërisë civile (Tema 8: Marrja e iniciativës në punën për paqe). Kapaciteti për të ndërmarrë këtë lloj veprimi duhet të jetë qëllimi thelbësor i edukimit për vllazërimin në një botë shumë të dëshiruar për paqe.

Synimet mësimore që tregojnë zgjidhjen e përmbajtjes së njohurive, zhvillimin e aftësive, dhe vlerave të shumicës së edukimeve janë rrjedhime të qëllimeve që shoqëria i konsideron si thelbësore për identitetin dhe mirëqenien e vet. Disa edukime synojnë që të ndikojnë tek shoqëria që ajo të adoptojë një qëllim të veçantë. Edukimi për paqe kërkon të demonstrojë se një shoqëri e edukuar për paqe ka me shumë mundësi të jetë e aftë për të arritur paqen. Qëllimi qëndror shoqëror i trajtimit për edukimin për paqe i shembëlluar këtu është ndalimi i luftës dhe arritja e kushteve themelore të paqes. Secila nga të katër bazat e Axfordës së Paqes ka një sferë të veçantë kontribuimesh substanciale dhe strategjike për të bërë që të arrihet ky qëllim. Gjithashtu, mësimi i rëndësishëm për paqe kalon në sfera të veçanta që ne i quajmë qëllime edukimore. Arritja e këtyre qëllimeve, ne besojmë, mund të jap një kontribut të veçantë në kapacitetet e individit dhe shoqërisë për të ndërmarrë veprime efektive për të ndaluar luftën.

Tabela 1

Qëllimet për Edukimin e Qytetarëve Njerëzor dhe të Përgjegjshëm

Vlerat e identifikuar këtu janë sygjyeruar si vlera paqeje thelbësore dhe tejkshuese që duhen kultivuar nga edukimi për kulturën e paqes. Kapacitetet janë cilësi njerëzore të cilat mund të realizohen nëpërmjet zhvillimit të aftësive. Vlerat dhe kapacitetet aplikohen si tek individët ashtu edhe tek shoqëritë.

Vlerat	Kapacitetet
Qëndrueshmëria Ambientale: Ruajtja e kapaciteteve të mbajtjes së jetës në Tokë	Vemendja Ekologjike: Vëzhgimi dhe pjesëmarrja në veprimet e nevojshme për ruajtjen e shëndetit të planetit Tokë
Integriteti/Diversiteti Kulturor: Respekt për cilësitë humane unike të të gjitha kulturave	Aftësia Kulturele: Vlerësimi i dallimeve kulturore dhe aftësia për të funksionuar shoqërisht në një kulturë tjetër
Solidariteti Njerëzor: Kuptimi së të gjithë njerëzit janë një specie dhe përkushtimi në mirëqenien e njerëzimit.	Veprimi Mbarëbotëror: Të vepruarit si një qytatar i botës për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e kulturës së paqes
Përgjegjshmëria Shoqërore: Ndërmarrja e veprimeve për mirëqenjen e komunitetit dhe përmirësimin e shoqërisë	Kompetencat mbi Konfliktin: Kapacitetet dhe aftësitë e duhura për zgjidhjen e konflikteve dhe zbatimit të pajtimit (procesi i konfliktit)
Barazia gjinore: Sigurimi i vlefshmërisë së barabartë të njerëzve dhe dinjitetit të grave dhe burrave	Ndjeshmëria gjinore: Vlerësimi i diferencave midis cilësive unike të burrave dhe grave, dhe aftësia për të vëzhguar e ndërmarrë veprime kur dallimet janë bazë e çfarëdo lloj diskriminimi.
E riprodhuar nga Reardon, B, Edukimi për Paqe në një Prospektive Gjinore, UNESCO, Paris 2001	

Tabela 2

Sekuena Zhvillimore për Konceptet Bazë dhe Përmbajtjen në Edukimin për Paqe
(si Edukimi për të Drejtat e Njeriut)

Niveli Zhvillimor	Konceptet dhe Vlerat Bazë	Standartet e Instrumentat e të Drejtave të Njeriut	Temat e Hagës
Fëmijëria Klasat e hershme	Vlerat Rregulli Respekti Mirësia	Rregullat e Klasës Deklarata e të Drejtave të Fëmijëve	Zëvendësimi i ligjit të forcës me forcën e ligjit

Mosha 5-8	Dallueshmëria Bashkëpunimi Përgjegjësia personale		
Fëmijëria e vonë Klasat e mesme Mosha 9-11	Ligji Qytetaria Të drejtat në komunitet Kartat Kushtetuta Liria Deklaratat Përgjegjësia shoqërore	Standartet Komunitare Deklarata e të Drejtave të Njeriut Karta Afrikane e Lirise Kushtetutat Kombëtare dhe Kartat Deklarate Universale e të Drejtave të Njeriut Konventa e të Drejtave të Fëmijëve	Të gjitha të drejtat e njeriut për të gjithë, gjetja e parave për paqen dhe boshatisja e fondeve të luftës
Adoleshenca Fillimi i shkollës së mesme Mosha 12-14	Drejtësia Barazia Paanësia Konventat Përgjegjësia botërore Ligji ndërkombëtar	Konventat rajonale të të Drejtave të Njeriut Konventat e KB: Eliminimi i racizmit; Diskriminimi ndaj grave; Të drejtat Civile e Politike; Të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore	Siguria njerëzore Globalizimi nga Poshtë-lart
Rinia Fundi i shkollës së mesme Mosha 15-17	Përfshirja morale Përgjegjësia morale Përfshirja morale Qytetaria mbarëbotërore Përgjegjësia Ekologjike	Principet e Nurembergut Konventat e KB: Parandalimi e Ndëshkimi i Genocidit; Parandalimi dhe Eliminimi i Torturës Gjykata Ndërkombëtare Penale	Dështimet tradicionale Ndërhyrjet humanitare Marrja e iniciativës në punën e paqes
<p>Rëndësia e Axhendës së Hagës për përmbajtjen e përgjithshme të edukimit për paqe ilustron duke vendosur temat kryesore të Axhendës së Hagës në vend të “Çështje dhe probleme” që dalin në version origjinal të kësaj table. (Shikoni tabelën # 5 për versionin origjinal të kësaj table).</p> <p>Shënim: Ne kemi vendosur “Gjykatën Ndërkombëtare Penale” në vend të “Gjetjes dhe Zhvillimit të Standarteve të reja” që del në versionin origjinal. Statuti i Romës për GjNP u adoptua në 1998. Burimi: <i>Edukimi për të Drejtat dhe Përgjegjësitë nga Betty A. Reardon, (1995), Filadelfia, Shtypshkronja e Universitetit të Pensilvanisë.</i></p> <p>Adaptuar nga <i>Edukimi për Dinjitet Njerëzor; Mësimi mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë nga Betty A. Reardon (1995) Filadelfia, Shtypshkronja e Universitetit të Pensilvanisë.</i></p>			

Baza 1: Shkaqet rrënjësore të Luftës/Kultura e Paqes

Promovimi i demokracisë në të gjitha nivelet e shoqërisë është një kërkesë parësore për të zëvendësuar shtetin e forcës me shtetin ligjor. Krijimi i proceseve më të përfaqësuara dhe demokratike të vendimmarrjes është një kërkesë primare për të arritur qeverisje të kufizuar e të përgjegjshme rajonale e globale, me mekanizma legjislativë të detyrueshëm, të zbatueshëm dhe të barabartë.

- *Axhenda e Hagës, Rekomandimet 8, faqe 19-20*

Toleranca, respekti për të drejtat e njeriut, dhe praktikimi i demokracisë janë dizenuar nga UNESCO si shtylla të një kulture paqeje, dhe nga Axhenda e Hagës si thelbësore për ndalimin e luftës. Prandaj, ne e shohim si të rëndësishme për Tabelën # 3 të Bazës 1 që të rradhisim qëllimet shoqërore që frymëzojnë edukimin për tolerancë, si faza e parë e një procesi më të gjatë e kompleks të lëvizjes së shoqërisë nga një kulturë dhune në një kulturë paqeje.

Armiqësia e shumta e të ashpra dhe konfliktet e armatosur ndërmjet grupeve etnike dhe fetare demonstrojnë se vlera initiale apo “hyrëse” mbi veprimet e atyre që kanë në dorë mundësimin e një kulture paqeje është toleranca. Ne zgjodhëm që të prezantonim qëllimet mësimore për këtë bazë të formuluar për një program të UNESCO për mësimin e tolerancës, që të demonstroi qëllimet shoqërore që ndodhen brenda qëllimeve edukative të kulturës së paqes, dhe për të ofruar një ilustrim se si një planveprim programor i ndërtuar rreth Axhendës së Hagës i shërben gjithashtu qëllimeve me përgjithësuese për një edukim për paqe gjithëpërfshirës.

Tre konceptet e vlerave mbi të cilat ky planveprim është ndërtuar janë ato të marra nga *Planveprimi i Integruar i Veprimit mbi Edukimin për Paqe, të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë (1994)* i UNESCO. Ato mund të interpretohen si qëllime sociale që shërbejnë nga edukimi për tolerancë, që është faza e parë e kalimit nga armiqësia dhe dhuna shoqërore nëpërmjet të tjera fazave të ndryshme të identifikuar në librin: *Toleranca: Pragu i Paqes* drejt një kulture paqeje. Të njëjtat qëllime shoqërore janë të shpallura dhe mbrojtura nga Axhenda e Hagës. Kjo tabelë shtron përpara vlerat me qëllimet që duhen ndjekur nëpërmjet edukimit, problemet që kanë sjellë këto synime, dhe proceset sociale që do të siguronin tolerancën dhe do të inkurajonin evolucionin e një kulture paqeje (Axhenda e Hagës, Baza 1). Në shikimin e Axhendës së Hagës, lexuesit do të venë re se proceset që tabela i lidh me paqen janë të ngjashme në përmbajtje me Bazën 3 mbi konfliktin. Ato që janë të lidhura me të drejtat e njeriut reflektojnë temat mbi të drejtat e njeriut të zhvilluara në Bazën 2 mbi të drejtat e njeriut, dhe ato që lidhen me demokracinë marrin disa nga rekomandimet e Bazës 4 mbi çarmatimin. E gjithë tabela mund të lexohet si kushte dhe procese esenciale të një kulture paqeje dhe disa prej të njëjtave karakteristika të një kulture të dhunës të identifikuar, veçanërisht në Bazën 1, në Axhendën e Hagës.

Në tekstin në vazhdim, ne kemi klasifikuar disa nga qëllimet e përgjithshme mësimore që janë përbërës të secilës nga katër Bazat e Axhendës së Hagës. Qëllimi ynë këtu nuk është të bëjmë një përkufizim definitiv se si duhet të jenë qëllimet e gjithë edukimeve për paqe, por që të identifikojmë qëllimet që kanë frymëzuar përmbajtjen e *Mësimi për Ndalimin e Luftës*, dhe për

të inkurajuar edukatorët e paqes që të ndërmarrin një trajtim të paramenduar dhe sistematik për planifikimin, adaptimin dhe krijimin e programeve të edukimit për paqe. Ne shpresojmë që të gjithë ata që ndërmarrin zhvillimin e programeve të edukimit për paqe do ti krijojnë ato mbi bazën e vlerave, njohurive dhe aftësive themelore që ata synojnë të kultivojnë drejt zhvillimit të qytetarisë së përgjegjshme të përkushtuar drejt paqes dhe drejtësisë.

Tabela # 3 identifikon qëllimet sociale në termat e qëllimeve specifike dhe problemeve prej të cilave erdhën këto qëllime, duke përsëritur formën e ndjekur nga Axhenda e Hagës me thënjen e një rekomandimi dhe shpjegimin e arsytimit të tij në një përkufizim të problemit që trajtohet nga rekomandimi. Konceptet e vlerave të rradhitura në këtë tabelë paraqesin qëllimet sociale të edukimit për tolerancë, paqe, të drejtat e njeriut, dhe demokracinë, të përfshira këto në *Planveprimin e Integruar të Veprimit mbi Edukimin për Paqe, të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë* të UNESCO. Ato formojnë vlerat thelbësore të një kulture paqeje.

Tabela 3

**Toleranca, një Planveprim Konceptual:
Qëllimet Shoqërore dhe Problemet**
(E adaptueshme për Edukimin për një Kulturë të Paqes)

Koncepte vlere	Qëllimet- Toleranca	Problemet-Intoleranca	Procese të Tolerancës
Paqja	Diskutimi civil, Konflikti konstruktiv, Lidhjet shoqërore Bashkëpunuese	Dhuna: fizike, kulturele, strukturore, psikologjike	Paqeruajtja dhe mjete të tjera të ndalimit të dhunës dhe kurimit të pasojave të saja shkatërruese Negocimi, arbitrazhi, ndërmjetësimi (zgjidhja pa dhunë e konflikteve) (Baza 3 e Axhedës së Hagës)
Të Drejtat e Njeriut	Ndryshueshmëria kulturore, diversiteti fetar, pluralizmi politik Paanësia ekonomike, drejtësia sociale, ambjenti i shëndetshëm	Dallimi gjinor, racizmi, etnocentrizmi, varfëria, shfrytëzimi, shtypja, paragjykimet, degradimi ambjental	Bashkëpunimi ndër kulturore, dialogu ndër fetar, mbrojtja e të drejtave të njeriut, shpërndarja e drejtë e burimeve, zhvillimi i qëndrueshëm (Baza 2 e Axhedës së Hagës)

Demokracia	Filozofi politike dhe opinione të shumëfishta, debat për politikën publike, informacion i plotë dhe haptazi i gjatshëm	Pengesat për pjesmarrje në politikë, mohimi i lirive themelore, censurimi e manipulimi i informacionit publik	Diskutim politik i pastër e i hapur, vendimmarrje përfaqësuese/pjesëmarrëse, informacion i përgjegjshëm, media e lirë për të informuar publikun mbi çështjet publike. (Baza 4 e Axhedës së Hagës)
Burimi: Toleranca dhe Pragu i Paqes, Njësia 1, Burimi i Trajnimit të Mësuesve, UNESCO, Paris, 1997. Ky është i pari nga tre volumet Njësia 2 është për tu përdorur në shkollat fillore dhe Njësia 3 është për tu përdorur në shkollat e mesme.			

Tabela 4

Toleranca: Qëllimet e Përgjithshme Mësimore

Vlerat	Njohuritë	Kapacitetet dhe Aftësitë	Baza për Vlerësim
Dinjteti Njerëzor (të drejtat e njeriut)	Varietetet e identiteteve njerëzore kulturore dhe personale, çështjet shoqërore	Jetesa me diversitet Bashkëpunimi ndër – kulturor, përdorimi i standarteve të të drejtave të njeriut për të bërë gjykime	Veprimi në detyrat aktuale ndërkulturore, veprimi në zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut në rastet e dhunimit
Drejtësia Sociale (demokracia)	Forma të shumëfishta të proceseve demokratike dhe atyre të qeverisjes	Ushtrimi i Përgjegjësisë Reflektimi kritik, komunikimi i fakteve dhe opinioneve, vendimmarrja politike	Prezantimi i interpretimit të situatave shembuj, prezantimi i përshkrimit të problemeve dhe i zgjidhjeve të mundshme, prezantimi i arsyeve për një pozicionim politik
Shoqëri e padhunëshme dhe bashkëpunuese (paqe)	Mënyra alternative të përgjigjes konstruktive për diferencat dhe konfliktet njerëzore	Manaxhimi i Konfliktëve Diskutime dhe debate, zgjidhja e konfliktëve, pajtimi, rindërtimi shoqëror, zgjidhja e përbashkët e problemeve dhe arritja e detyrave	Argumente me gojë dhe me shkrim që përshkruajnë alternativat, zgjedhja e njërit, dhe tregimi i arsyeve për këtë zgjedhje; simulimi i procedurave të zgjidhjes së konfliktëve dhe përjasjet për pajtimin

Burimi: *Toleranca: Pragu i Paqes*, Njësia 1, UNESCO, 1977, f. 55.

Tabela # 4 prezanton qëllimet mësimore të rrjedhura nga synimet shoqërore të ilustruara në Tabelën # 3. Mund të shihet me lehtësi se këto qëllime janë konsistente dhe përmbushëse me ato që janë rradhitur këtu në lidhje me tre bazat e tjera.

Kjo tabelë, edhe një herë duke filluar nga një bazë vlerash si trajtimi ynë për edukimin për paqe, jep kategoritë e përgjithshme të njohurive që duhen transmetuar nëpërmjet përmbajtjes së programit; disa prej aftësive dhe zotësive thelbësore që duhen zhvilluar nëpërmjet metodave të përshtatshme të mësimit; si dhe mënyrat për të matur apo vlerësuar mësimin. Këto janë sferat qendrore të planifikimit të programeve për edukimin për paqe: identifikimi dhe qartësimi i vlerave thelbësore; zgjedhja e përmbajtjes; krijimi i metodave të mësimit; krijimi i një mënyre vlerësimi.

Pjesa e mëposhtme shpjegon qëllimet mësimore me një përkufizim të cituar në të njëjtin burim të UNESCO. Përkufizimi është publikuar në fillim nga Seminari i Qëndrueshëm për Paqen në Spanjë.

Objektivat e Procesit të Mësimit të Tolerancës

Objektivat e veçanta që do të ekspozohen nga mësuesit e angazhuar në procesin mësimor për tolerancë janë të artikuluar e rradhitura në objektivat qendror të një njësie mbi tolerancën të përgatitur për Vitin Ndërkombëtar të Tolerancës nga Seminari i Qëndrueshëm për Paqen në Spanjë.

Objektivat janë që të:

- 1. Të zhvillohet sensibilizimi mbi shkaqet e dhunës dhe intolerancës brenda një shpirti bashkëpunimi dhe paqeje;**
- 2. Të promovohet një edukim i mbështetur mbi tolerancën dhe respektin për të tjerët, sidomos për ata që janë lënë mënjanë në shoqërinë e sotme;**

3. Të forcohen komunikimi dhe liria e shprehjes në betejën kundër të gjitha formave të diskriminimit dhe marzhinalizimit, dhe të zhvillohet bindja se toleranca manifestohet më mirë në respektin për dinjitetin e personave dhe në lirinë politike;
4. Të përgatiten studentët për të jetuar në një shoqëri shumëkulturore të ndryshueshme që kërkon një sjellje tolerance dhe pranimi për kulturat e tjera, që lufton kundrejt trajtimit jonjerëzor dhe degradues, dhe që respekton individët njerëzor pa dallim seksi, moshe, race, gjuhe, feje, opinioni politik, origjine kombëtare apo sociale,
5. Të kontribuojë në zhvillimin e paqes, solidaritetit, dhe mirëkuptimit e bashkëpunimit ndërkombëtar;
6. Të denoncojë pamjet e gabuara dhe dogmatike të fanatizmit të gjitha llojeve; të jap mbështetje me një shpirt kritik në favor të bashkëjetesës dhe tolerancës si mënyra më e mirë e kuptimit midis individëve dhe popujve;
7. Të krijojë (nëpër klasa) zakone dhe sjellje për zgjidhjen e problemeve në mënyra krijuese dhe dialoguese, duke përfshirë vlerat e paqes, drejtësisë, solidaritetit, bashkëpunimit, dhe tolerancës në jetën tonë të përditshme;
8. Ti mësojë studentëve nevojën e heqjes dorë nga dhuna dhe për adoptimin e metodave paqësore për zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve;
9. Të frymëzojë në gjeneratat e tanishme të studentëve- të cilët do të mbajnë pozicionet e ardhshme të përgjegjësisë- ndjenjat e altruizmit, hapjes, respektit për të tjerët, solidaritetit, dhe pjesëmarrjes të bazuar në identitetet personale si dhe kapacitetin për të kuptuar se ka shumë mënyra për të qenë njerëzor në kontekstet e ndryshme kulturore dhe shoqërore.

Këto dhjetë pika ofrojnë një përmbledhje të nevojshme të qëllimeve mësimore të edukimit për eliminimin e shkaqeve të luftës dhe për krijimin e kushteve për një kulturë paqeje.

Sygjerime për Lexime

- ◆ *Education for a Culture of Peace in a Gender Prospective, (Edukimi për një Kulturë Paqeje në një Perspektivë Gjimore)*, nga Betty A. Reardon, UNESCO, Paris, 2001
- ◆ *Tolerance: The Threshold of Peace (Toleranca: Pragu i Paqes)*, Njësia 1: Trajnimi i Mësuesve, nga Betty A. Reardon, UNESCO, Paris, 1997.

Baza 2: Ligji dhe Institucionët Humanitare dhe të të Drejtave të Njeriut

Gjithnjë e më në rritje, komuniteti ndërkombëtar ka marrë përsipër përgjegjësinë për...ndërtimin e institucioneve në shoqëritë post-konfliktuale. Thirrja e Hagës mbron masat për të siguruar që mbrojtja afatgjatë dhe sistematike e të drejtave të njeriut të jetë një prioritet i këtyre proceseve.

- Axhenda e Hagës, Rekomandimet 24, f. 31

Ka dy aspekte të marrëdhënjes domethënëse midis të drejtave të njeriut dhe edukimit për paqe. Njëri është kur në një rast lufte, të drejtat dhunohen sistematikisht dhe vazhdimisht, dhe tjetri është “themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë” (Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Preambula). Ne besojmë se realizimi i plotë i të drejtave të njeriut do të sjellë një kulturë paqeje.

Për të propozuar qëllimin mësimor të kësaj baze mbi ligjin humanitar dhe të të drejtave të njeriut, ne u referohemi atyre të rradhitura në sekuencën e mësimin zhvillimor që cituar nga një program për edukimin e të drejtave të njeriut, të adaptuar si Tabela # 2. Ne kemi futur versionin origjinal si Tabela # 5 si dhe tekstin shoqërues në burimin origjinal. Ne besojmë se sekuencat zhvilluese si ato të rradhitura në tabelë janë të aplikueshme për qëllimet e të katër bazave të Axhendës së Hagës. Për shkak se burimi origjinal ishte krijuar për tu përdorur në shkollat e Amerikës Veriore, disa edukatorë mund të duan të ndryshojnë dokumentat kombëtare që sigurojnë të drejtat e njeriut në vendet e tyre.

Për të përmbushur tabelën # 5 ne përfshijmë këtu disa nga principet thelbësore rreth të cilave edukimi për të drejtat e njeriut ka krijuar programe. Ne besojmë se këto principe do të jenë të dobishme në ndjekjen e qëllimeve mësimore për arritjen e rekomandimeve të kësaj baze.

Tabela 5

Sekuena Zhvillimore për Konceptet Bazë dhe Përmbajtjen

Kjo tabelë ilustron gjithashtu nivelet zhvillimore në të cilat standartet e të Drejtave të Njeriut mund të futen në program, dhe moshën e nivelin e klasës së përshtatshme për prezantimin e koncepteve thelbësore dhe shumë nga problemet kryesore të të drejtave të njeriut. Ndërsa konceptet themelore kërkojnë të shprehin vlera që janë universale dhe gjithëpërfshirëse, nën-konceptet programor janë shprehje të këtyre vlerave ashtu si janë përkufizuar brenda konteksteve të veçantë kulturor dhe historikë. Universaliteti i të drejtave të njeriut gjendet brenda principeve të përgjithshëm normativë të dinjitetit njerëzor dhe manifestohen në mënyrat e shumta e të ndryshme që kulturat kanë krijuar për drejtimin e jetës njerëzore. Qëllimi i këtyre personave është që të sigurojnë dinjitetin njerëzor, dhe jo të vendosin një konformizëm që do të kufizonte potencialet njerëzore.

Sekuena zhvillimore e paraqitur këtu njeh gjithashtu diversitetin njerëzor. Ajo nuk paramendon një tip universal e të pandryshuar të zhvillimit mësimor. Ajo synon vetëm të japi disa udhëzime të përgjithshme për të siguruar procese mësimore të përqëndruara tek nxënësi, dhe për të ofruar përmbajtje sa më të rëndësishme që të jetë e mundur për grupe të veçanta nxënësish, të organizuara sipas nivelit të klasave. Konceptet dhe vlerat bazë paraqiten nëpër gjithë sekuencën, por paraqiten në mënyrë me komplekse kur niveli zhvillimor shkon drejt rritjes.

Niveli Zhvillimor	Konceptet dhe Vlerat Bazë	Standartet e Instrumentat e të Drejtave të Njeriut	Çështjet dhe Problemet
Fëmijëria Klasat e hershme Moshë 5-8	Vlerat Rregulli Respekti Mirësia Dallueshmëria Bashkëpunimi Përgjegjësia personale	Rregullat e Klasës Deklarata e të Drejtave të Fëmijëve	Pabarazia Padrejtësitë Dëmtimi
Fëmijëria e vonë Klasat e mesme Moshë 9-11	Ligji Qytetaria Të drejtat në komunitet Kartat Kushtetuta Liria Deklaratat Përgjegjësia shoqërore	Standartet Komunitare Deklarata e Pamvarësisë Karta Afrikane e Lirisë Karta Amerikane e Lirisë Karta e të Drejtave të SHBA Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut Konventa e të Drejtave të Fëmijëve	Paragjykimet Diskriminimi Varfëria Padrejtësitë
Adoleshenca Fillimi i shkollës së mesme Moshë 12-14	Drejtësia Barazia Paanësia Konventat Përgjegjësia botërore Ligji ndërkombëtar	Konventat rajonale të të Drejtave të Njeriut Konventat e KB: Eliminimi i racizmit; Diskriminimi ndaj grave; Të drejtat Civile e Politike; Të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore	Etnocentrizmi Racizmi Dallimi gjinor Autoritarizmi Kolonializmi Uria
Rinia Fundi i shkollës së mesme Moshë 15-17	Përrjashtësi morale Përgjegjësia morale Përfshirja morale Qytetaria mbarëbotërore Përgjegjësia Ekologjike	Principet e Nurembergut Konventat e KB: Parandalimi e Ndëshkimi i Genocidit; Parandalimi dhe Eliminimi i Torturës Gjetja dhe Zhvillimi i Standarteve të reja	Etnocidi Genocidi Tortura Shtypja Politike Abuzimi i Ambjentit

Burimi: *Edukimi për të Drejtat dhe Përgjegjësitë nga Betty A. Reardon, (1995), Filadelfia, Shtypshkronja e Universitetit të Pensilvanisë.*

Principe të Mësimit për dhe mbi të Drejtat e Njeriut

Principet e mëposhtme janë adoptuar nga Local Action/Global Change: Learning about Human Rights of Women and Girls, (Mësimi rreth të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Vajzave), nga Julie Mertus, Nancy Flowers dhe Mallika Dutt, e publikuar nga UNIFEM dhe Qendra e Femrave për Drejtimin Global (1999). Ndërsa disa nga principet janë krijuar në termat e të drejtave të njeriut të grave, ato u përmbahen të drejtave të njeriut të të gjithëve dhe kanë rëndësi dhe aplikueshmëri të veçantë për të drejtat e atyre që vuajnë nga forma specifike të diskriminimit dhe marzhinalizimit.

Principi 1: Dinjiteti – Baza thelbësore e të drejtave të njeriut është mbrojtja dhe promovimi i dinjitetit njerëzor.

Principi 2: Universalizmi – Natyra universale e të drejtave nuk do të thotë që ato mbahen në të njëjtën mënyrë nga të gjithë njerëzit. Universalizmi do të thotë që qeveritë dhe komunitetet duhet tu përmbahen disa vlerave morale dhe etike që përshkojnë të gjithë rajonet e botës.

Principi 3: Barazia dhe Mos-Diskriminimi – Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe të tjera dokumenta ndërkombëtare të të drejtave të njeriut u japin të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si femrave ashtu edhe meshkujve, gjithë vajzave dhe djemve, për shkak të humanizmit të tyre, pamvarësisht nga çdo rol apo lidhje që ata mund të kenë. Kur dhunimet kundër grave nuk njihen si abuzime të të drejtave të njeriut, gratë ulen bashkërisht si qenie njerëzore dhe u mohohet personaliteti që ato kanë.

Principi 4: Pandashmëria – Të drejtat e njeriut duhen trajtuar si një trup i vetëm, duke përfshirë të drejtat politike, sociale, ekonomike, kulturore dhe kolektive. Atyre nuk mund t'u jepen "prioritete" apo të ndahen në "breza" të drejtash, disa prej të cilave duhen arritur përpara të tjerëve.

Principi 5: Ndërlidhshmëria – Shqetësimet mbi të drejtat e njeriut shfaqen në të gjitha fushat e jetës, shtëpi, shkollë, vendin e punës, gjyqe etj. Dhunimet e të drejtave të njeriut janë të ndërlidhura; humbja e të drejtave të njeriut në një fushë mund të nënkuptojë humbje në një tjetër. Në të njëjtën kohë, promovimi i të drejtave të njeriut në një fushë ndihmon të tjera të drejta të njeriut.

Principi 6: Përgjegjësia Qeveritare – Qeveritë kanë gjithashtu përgjegjësi të ofrojnë edukim për të drejtat e njeriut, paqe, dhe demokraci.

Principi 7: Përgjegjësia Private – Qeveritë nuk janë të vetmit fajtorë të dhunimeve të të drejtave të grave. Korporatat dhe individet gjithashtu duhen mbajtur përgjegjës; principet morale kulturore dhe traditat shoqërore që nënshtrajnë gratë duhet që të sfidohen.

Ne i shohim këto principe si shumë të rëndësishme dhe të dobishme për zhvillimin e programeve për mësimin e kësaj baze të Axhendës së Hagës. Të gjithë edukimet për të drejtat e njeriut, sidomos ai i ndërmarrë brenda këtij planveprimi, duhet që të rrjedhin nga principe që dalin nga principet bazë të dinjitetit njerëzor.

Sygjerime për Lexime:

- ◆ *UNESCO, Edukimi për të Drejtat e Njeriut, Paqen dhe Demokracinë: një Libër Dore & Material Mësimor.* Qendra Edukimore Libaneze për Kërkim dhe Zhvillim, Shoqata Ndërkombëtare për Kërkimet e Paqes, në bashkëpunim me UNESCO, 2000.
- ◆ *Education for Development*, (Edukimi për Zhvillim), Nakada-Slap dhe UNESCO, Brezara, Kroaci 1999.
- ◆ *Local Action/Global Change: Learning about Human Rights of Women and Girls, (Mësimi rreth të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Vajzave)*, nga Julie Mertus, Nancy Flowers dhe Mallika Dutt, e publikuar nga UNIFEM dhe Qendra e Femrave për Drejtimin Global (1999).

Baza 3: Parandalimi, Zgjidhja, dhe Transformimi i Konfliktit të Dhunshëm

Mundësia e rinisë për pjesëmarrje në ndërtimin e paqes është esenciale në thyerjen e ciklit të dhunës, për të ulur dhe evituar konfliktin. Të gjithë le të ndajmë vizionin, tolerancën, solidaritetin, dhe dëshirën tonë për të mësuar në një shkëmbim të vërtetë ndër-gjeneratash të bazuar në respektin, besimin dhe përgjegjësinë e dyanshme.

- Axhenda e Hagës, Rekomandimet 35, f. 37

Zgjidhja e konflikteve është ndoshta përqsja më gjerësisht e praktikuar në edukimin për paqe. Shumë shpesh është e vetmja përqsje e përdorur dhe nuk ofrohet në lidhje me të tjera çështje globale si drejtësia dhe paqja dhe forma të tjera të edukimit për paqe. Duke qënë se ne synojmë me anë të këtij burimi të përdorim planveprimin konceptual të ofruar nga Axhenda e Hagës për të dhënë një kontribut të ri në fushën e edukimit për paqe, ne gjithashtu synojmë të propozojmë një proces përqsje për konfliktin që të kontribuojmë në integrimin e zgjidhjes së konfliktit në edukimin gjithëpërfshirës për paqe. Konceptet bazë të procesit janë të vendosura në Kapitullin 2, ku zgjidhja e konfliktit përshkruhet si një përbërës i planveprimin konceptual të rrjedhur nga katër bazat e Axhendës së Hagës. Ne sygjerojmë që ju të rishikoni këto përkufizime përpara se të lexoni Tabelen # 6, e cila rradhit disa nga qëllimet mësimore që ne propozojmë për të mësuar se si të trajtohet konflikti brenda një procesi përqsje. Ashtu si me të tre këto njësi mësimore, ky propozim gjithashtu po rregullohet nëpërmjet rishikimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm. Ai po zhvillohet nga Skuadra e Edukimit të Paqes në Kolegjin e Mësuesve në Universitetin e Kolumbias. Përgjigje nga mësuesit të interesuar në këtë përqsje do të jenë shumë mirepritura. (Ju lutem dërgoni sygjerime në adresën Peace Education Center, Teachers College #171, Columbia University, New York, New York 10027, U.S.A.)

Sygjerime për Lexime

- ◆ ***Edukimi për të Drejtat e Njeriut, Paqen dhe Demokracinë: një Libër Dore & Material Mësimor.*** Qendra Edukimore Libaneze për Kërkim dhe Zhvillim, Shoqata Ndërkombëtare për Kërkimet e Paqes, në bashkëpunim me UNESCO, 2000.
- ◆ ***Extending Peaceful Relationship: A Selection of Activities for Classes and Groups/Ages 11-14 (Zgjerimi i Marrëdhënjeve Paqësore: Një Përzgjedhje Aktivitetesh për Klasa dhe Grupe/Mosha 11-14)***, Fondacioni i Zelandës së Re për Studimet e Paqes, Auckland, 1986.
- ◆ ***Teaching Young Children in Violent Times: Building a Peaceable Classroom, (Mësimi e Fëmijëve në Kohëra të Dhunshme: Ndërtimi i një Klase Paqësore)***, Diane E. Levin Ph.D., Edukatorët për Përgjegjësi Sociale, adresa 23 Garden Street, Cambridge, MA. 02138, 1994

Ekziston literaturë e gjerë mbi edukimin për zgjidhjen e konflikteve. Bibliografia e zgjedhur mund të gjendet në Qendrën e Edukimit për Paqe, Kolegji i Mësuesve, Universiteti i Kolumbias.

Baza 4: Çarmatimi dhe Siguria Njerëzore

Thirrja e Hagës ka si vizion një botë pa dhunë, të arritshme nëpërmjet një kodi të ri të sjelljes ndërkombëtare, i cili kufizon fuqinë ushtarake dhe përqafton jo-dhunën dhe përmbajtjen në ligjin ndërkombëtar.

- Axhenda e Hagës, Rekomandimet 50, f. 48

Edukimi për çarmatimin është më pak i zhvilluari nga të gjitha përqaftjet e edukimit për paqe. Për shkak se politikat dhe aspektet teknike të çarmatimit u janë dukur të frikshme shumicës së edukatorëve dhe sepse shtetet e kanë dekurajuar këtë gjë, ky edukim ngelet i pjesshëm dhe anësor për këtë fushë. Shumica e programeve të pakta që janë krijuar merren me armët bërthamore dhe jo me volumin dhe varietetin e armëve me të cilat luftohet në shumicën e konflikteve të armatosura. Këto kufizime ekzistojnë pamvarësisht nga marreveshja e arritur në Kongresin Botëror mbi Edukimin për Çarmatim të organizuar nga UNESCO në 1980 në përputhje me Seksionin e Posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme mbi Çarmatimin të vitit 1978. Ky Kongres parashikoi shumicën e asaj që Axhenda e Hagës jep si bazë për edukimin mbi çarmatimin për një kulture paqeje. Shumë instruktiv ishte identifikimi i principeve themelore për zhvillimin e kësaj pjese të edukimit për paqe.

Tabela 6

Qëllimet Mësimore të Parandalimit, Zgjidhjes dhe Transformimit të Konflikteve			
Procesi i Konfliktit	Njohuria	Aftësitë	Vlerat
Parapritja Përfaqësimi Parandalimi Shpërndarja e burimeve Diferencat në fuqi	Procesi Demokratik Hierarkitë Sociale Njohja e Paragjykimeve Njohja e Mohimeve	Paraqitja e Çështjeve Analizimi i Paramendimeve Bashkëpunimi	Barazia në pjesëmarrje Drejtësia
Analiza Parandalimi Zgjidhja Perspektivat kulturore Ndjeshmëria emocionale	Raste të zgjidhura me paqe Faktorë të shumtë të konfliktit Llojet e shkallëzimit Ndjeshmëria/Dinjiteti	Kërkimi/Hetimi Mënyra të ndryshme analizimi Analiza e nevojave	Jo-Dhuna Diversiteti Respekti për të tjerët
Zgjidhja e Problemeve Zgjidhja Rezultati Konflikti Përqaftje të ndryshme të zgjidhjes së konflikteve	Efektet e Sjelljeve Ndryshimet në synime dhe interpretimi i sinjaleve Perifrazimi Afirmimi	Ç'skallëzimi Dëgjimi aktiv Toleranca	Komuniteti Dyanëshmëria Tregimi i sinjaleve

Menaxhim Konflikti			
Zgjidhja Transformimi	Mekanizmat institucionalë Agjensitë dhe shërbimet	Marrja e aksesit Zgjedhja e mënyrës së përshtatshme	Akses i barabartë E drejta për ankim dhe shërbime
Transformimi			
Kalimi nga debati destruktiv në konstruktiv	Mënyrat e protestës, rezistenca jo e dhunshme Teoritë e Jo-dhunës	Organizimi dhe trainimi Strategjitë e Jo-dhunës	Ndryshimi pozitiv Respekti për jetën
Pajtimi			
Marrëdhënjet Transformimi	Shërimi dhe Pajtimi	Krijimi i marrëdhënjeve Përpjekjet e përbashkëta	Paqja Pozitive Dinjiteti njerëzor
Rindërtimi			
Transformimi Pamvarësia	Të drejtat e njeriut dhe ligji ndërkombëtar Mësimi i përbashkët	Parashikimi i alternativave Bashkëjetesa	Kultura e paqes Bashkëpunimi
Shënim: Kjo tabelë, ashtu si edhe përfaqësja konceptuale e konfliktit si një proces me shumë faza, është në përpunim nga Janet Gerson, Drejtoreshë e Përbashkët e Qendrës së Edukimit për Paqe në Kolegjin e Mësuesve dhe antare e Skuadrës së Edukimit për Paqe.			

DHJETË PRINCIPE TË EDUKIMIT PËR ÇARMATIM

Siç thuhet në *Edukimin për Çarmatim*, dokumentin final të Kongresit Botëror mbi Edukimin për Çarmatim (Paris:UNESCO, 1980), edukimi për çarmatim duhet të drejtohet nga principet dhe direktivat e mëposhtme:

Lidhja e edukimit me çarmatimin

Edukimi mbi çarmatimin, një përbërës esencial i edukimit për paqe, nënkupton si edukimin rreth çarmatimit ashtu edhe edukimin për çarmatim. Të gjithë ata që merren me edukim duhet të jenë të ndërgjegjshëm dhe të krijojnë një ndërgjegje të faktorëve që qëndrojnë prapa prodhimit dhe blerjes së armëve, të pasojave sociale, politike, ekonomike dhe kulturore të garave të armatimit, të rrezikut të madh për mbijetesën e njerëzimit, nga ekzistenca dhe përdorimi potencial i armëve bërthamore.

Përkufizimi i Çarmatimit

Për qëllimin e edukimit për çarmatim, çarmatim mund të konsiderohet çdo formë veprimi që synon kufizimin, kontrollin, apo uljen e numrit të armëve, duke përfshirë edhe iniciativat e

njëanshme për çarmatimi, dhe, së fundmi, çarmatimi i përgjithshëm e i kompletuar nën kontrollin efektiv ndërkombëtar. Gjithashtu mund të nënkuptohet si një proces që synon transformimin e sistemit të tanishëm të shteteve të armatosura në një rend të ri botëror të një paqeje të planifikuar pa armë, në të cilin lufta nuk është më një instrument i politikës kombëtare dhe popujt vendosin vetë të ardhmen e tyre dhe jetojnë në një siguri të bazuar në drejtësi dhe solidaritet.

Lidhja me realitetet ekonomike dhe politike

Edukimi për çarmatim nuk mund, sidoqoftë, të kufizoj veten në shpërndarjen e të dhënave dhe informacionit mbi projektet dhe prospektet e çarmatimit, as vetëm me komentimin mbi shpresat dhe idealet që i frymëzuan ato. Duhet që të njohi plotësisht lidhjen që çarmatimi ka me arritjen e sigurisë ndërkombëtare të sigurisë dhe arritjes së zhvillimit. Për të qenë efektiv në këtë drejtim, edukimi për çarmatim duhet që të lidhet me jetën dhe shqetësimet e nxënësve dhe realitetet politike brenda të cilave çarmatimi kërkohet dhe duhet që të japi të dhëna mbi faktorët politikë, ekonomik e social mbi të cilët siguria e njerëzve mund të bazohet.

Përqsasja Substanciale

Si një përqsasje tek paqja dhe siguria ndërkombëtare, edukimi për çarmatim duhet të marrë parasysh principet e ligjit ndërkombëtar të bazuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, në veçanti, ndalimin e kërcënimit për përdorimin e forcës kundrejt integritetit territorial apo pamvarësisë politike të shteteve, zgjidhjen paqësore të konflikteve, mos-ndërhyrjen në punët e brendëshme, dhe vetëvendosjen e popujve. Duhet gjithashtu të varet tek ligjet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe ligjit ndërkombëtar humanitar të aplikueshëm në rast konflikti të armatosur dhe të konsiderojë përqsasje alternative për sigurinë, duke përfshirë këtu sistemet mbrojtëse jo ushtarake dhe veprimet civile jo të dhunshme. Studimi i përpjekjeve të Kombeve të Bashkuara, i masave të ndërtimit të besimit, të paqeruajtjes, të zgjidhjes paqësore të konflikteve, dhe të mënyrave të tjera për të kontrolluar dhunën ndërkombëtare marrin rëndësi të veçante në këtë drejtim. Vëmendja e veçantë duhet t'u jepet në programet e edukimit për çarmatim të drejtës për kundërshtim të ndërgjegjshëm dhe të drejtës për të refuzuar vrasjen. Edukimi për paqe duhet të jap një rast për të eksploruar, pa paragjykuar çështjen, implikimet për çarmatim të shkaqeve rrënjësore të dhunës individuale e kolektive dhe të shkaqeve subjektive e objektive të tensioneve, krizave, përplasjeve dhe konflikteve që karakterizojnë strukturat kombëtare e ndërkombëtare duke reflektuar pabarazinë dhe drejtësinë.

Lidhjet me të drejtat e njeriut dhe zhvillimit

Si një pjesë përbërëse e edukimit për paqe, edukimi për çarmatim ka lidhje esenciale me edukimin për të drejtat e njeriut dhe edukimin për zhvillim, për aq sa secili nga këto tre terma, paqe, të drejtat e njeriut dhe zhvillim, duhet të përkufizohet në lidhje me dy të tjerët. Për më tepër, edukimi për çarmatim ofron një rast për të ndriçuar koncepte të sapo dala si e drejta individuale dhe kolektive për paqe dhe zhvillim, të bazuara në përmbushjen e nevojave njerëzore materiale dhe jo-materiale.

Këto principe japin drejtime që rforcojnë qëllimet e mendimit kritik dhe krijimit të ndërlidhjeve midis problemeve dhe çështjeve që janë kryesore për përfaqshjen tonë tek edukimi për paqe.

Ne besojmë se planveprimi i Axhendës së Hagës ofron një dimension të ri të edukimit për çarmatim. Duke kombinuar çarmatimin me sigurinë njerëzore, Axhenda e Hagës ofron një konceptualizim më shpejt të adoptueshëm në shkollat fillore dhe të mesme dhe në edukimin gjithëpërfshirës për paqe. Siç treguam në kapitullin për planveprimin, çështjet e çarmatimit dhe sigurisë njerëzore adaptohen lehtë me një mënyrë kërkimore pedagogjike, që ndiqet më mirë nëpërmjet diskutimeve siç është prezantuar në Kapitullin 4 mbi metodat. Në shprehim se edukatorët e paqes do të ndërmarrin më shumë koncepte të sigurisë njerëzore. Fushata Globale do të ndërmarrë zhvillime të mëtejshme në këtë fushë si pasojë e *Studimit të Kombeve të Bashkuara mbi Edukimin për Çarmatimin dhe Mos-Përhapjen e Armëve Bërthamore*,

Dokument i KB: A/RES/55/33E (igjetshëm në internet në faqen:

<http://www.un.org/documents/ga/res/55/a55r033.pdf>)

Arritja e çarmatimit dhe transformimi i sistemit të sigurisë globale nga ai i bazuar në sigurinë ushtarake të shteteve në atë të dedikuar për sigurinë njerëzore të popujve të botës janë dy qëllimet sociale për qëllimet mësimore në edukimin për çarmatimin të propozuar këtu. Për shkak se këto janë dy proceset kryesore të ndryshimit struktural që kërkohet për një kulturë paqeje, qëllimet mësimore për këtë bazë janë të vendosura si ato përbërëse të një perspektive të përgjithshme të bazuar në analizën e problemeve që ndriçon ndërlidhjen mes problemeve të trajtuara nga propozimet që përbëjnë Axhendën e Hagës. Duhet gjithashtu që të kuptohet se çarmatimi gjithashtu kërkon ndryshime domethënëse të sistemeve në të gjitha fushat e rendit të sotëm botëror, të ekonomise botërore, të konfliktit dhe proceseve e institucioneve paqeruajtës, të drejtave të njeriut, dhe mjedisit.

Tabela # 7 përmbledh qëllimet mësimore përbërëse të kësaj baze dhe tregon shkurtimisht lidhjen e tyre me substancën dhe qëllimet mësimore të të gjitha bazave të Axhendës së Hagës.

Qëllimet e Njohurive të Edukimit për Çarmatim

Një rradhitje e njohurive përmbajtese mund të nxirret nga çështjet dhe problemet që formojnë hetimin për çarmatim të paraqitur në planveprimin në Kapitullin 2. Ne gjithashtu rekomandojmë që lexuesit të drejtohen për të kuptuar substancën e “Veprimeve Kryesore” të Axhendës së Hagës që merret me çështjet e çarmatimit: armët e vogla, minat e tokës, armët bërthamore, si dhe përfaqsimin gjithëpërfshirës të Veprimit Mbarëbotëror për të Ndaluar Luftën. Ne gjithashtu, do të rekomandonim që studimi i qëllimeve dhe çështjeve të lidhura me negociatat e traktateve me të rëndësishëm mbi kontrollin e armëve, të paraqitet në klasat e larta të shkollave të mesme. Studentët gjithashtu duhet të jenë të aftë të dallojnë ndryshimet midis koncepteve dhe qëllimeve të kontrollit të armëve, çarmatimit, si dhe çarmatimit të përgjithshëm dhe të kompletuar, të nevojshëm për një sistem ndërkombëtar të bazuar në sigurinë njerëzore.

Me e rëndësishmja për ta bërë çarmatimin të rëndësishëm për nxënësit është që ata të arrijnë të kuptojnë se si çarmatimi është pjesë përbërëse e zgjidhjes së shumicës së problemeve globale, e veçanërisht atyre të adresuara nga tre bazat e tjera. Studentët duhet të dinë se një kulturë paqeje nuk mundet kurrë që të arrihet në një botë tepër të armatosur, dhe se armatimi më shumë e kërcënon sesa e mbron paqen. Ata duhet të kuptojnë se si sistemet ushtarake dhe armatimet janë instrumenta të shtypjes dhe të tjera forma të dhunimeve të të drejtave të njeriut, dhe se çarmatimi mund të arrihet dhe mbahet vetëm nëpërmjet ligjit ndërkombëtar të traktateve dhe përkushtimit të shteteve. Ata duhet të dinë se, pa preferencën e proceseve jo të dhunshme të zgjidhjes së konflikteve dhe krijimit të

Tabela 7

Qëllimet Mësimore të Propozuara për Edukimin për Paqe

Klasa/Niveli i Zhvillimit	Njohuria e Koncepteve të Çarmatimit	Aftësitë Paqebërëse	Vlerat e Kulturës së Paqes	Lidhja me të Katërta Bazat
Fillore Fëmijët	Armët Dhuna Konflikti	Imagjinimi i pasojave Diskutimi i ndryshimeve Zgjidhja e konflikteve	Respekti për jetën repekti për të tjerët Respektimi i jodhunës	Kultura e Paqes të Drejtat e Njeriut Procesi i Konfliktit
E mesme Adoleshentët	Kontrolli i Armëve Çarmatimi Çarmatimi Berthamor Çarmatimi i përgjithshëm dhe komplet Prodhimi i Armëve Tregtia e Armëve	Përkufizimi i koncepteve Dallimi i ndryshimeve konceptuale Projektimi i pasojave të kushteve të tanishme Kuptimi i propozimeve për Ndryshime të bërë nga	Diskutime të hapura të politikave publike Vlerësimi në perspektivë i ndryshimeve Respekti për shqetësimet dhe problemet e të tjerëve Përfaqje dhe perspektiva	Procesi i Konfliktit Kultura e Paqes të Drejtat e Njeriut

	Axhenda e Hagës	të shumta	Çarmatimi
Dytësore Të rinjtë	Pasojat Ekonomike dhe Ekologjike të armatimit dhe konflikteve të armatosura Principet e propozimeve për Çarmatim, si Veprimi Global për Ndalimin e Luftës Traktatet dhe marrëveshjet për kontrollin e Armëve Sisteme sigurie alternative Koncepte të sigurisë Njerëzore	Marrja e një perspektive gjithëpërfshirëse Krijimi i ndërlidhjeve midis sigurisë së armatosur dhe problemeve të tjera globale Vlerësimi i propozimeve dhe pasojave Analiza kritike Imagjinata krijuese	Shqetësimi për Token Respekti për përkushtimet dhe marrëveshjet Të menduarit reflektiv Përkushtimi për më të prekshmit dhe të lënë të mënjanë Kultura e Paqes Ligji Ndërkombëtar Procesi i Konfliktit Siguria Njerëzore

Shenim: Thirrja e Hagës për Paqe është në këtë moment në bashkëpunim me Departamentin për Çështjet e Çarmatimit të Kombeve të Bashkuara për të paraqitur edukimin për çarmatim në një program pilot ndërsa mblidhen armët e vogla

institucioneve që i sigurojnë ato, bota nuk do të mund që të çarmatoset. Ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për pasojat mbi sigurinë njerëzore të shpenzimeve ushtarake që kufizon burimet për të siguruar nevojat e mbijetesës së të varfërve dhe të marzhinalizuarve, të gjithë njerëzve më të prekshëm të botës. Prandaj, ata mund të arrijnë të kuptojnë se siguria njerëzore është rezultat i çarmatimit dhe proceseve përmbushëse të tjera të mbrojtura nga Axhenda e Hagës.

Aftësi që duhen Zhvilluar nëpërmjet Edukimit për Çarmatim

Aftësitë kritikuese dhe analizuese që mbrohen si qëllime edukimore të shumicës së edukimeve për paqe janë veçanërisht të rëndësishme për studimin e çarmatimit. Mësimi e vlerësimit dhe projektimit të efekteve të mundëshme të propozimeve të lidhura me armët dhe çështjet e sigurisë është thelbësor për qytetarinë mbarëbotërore efektive dhe aktive. Edukimi për paqe gjithashtu synon të zhvillojë aftësitë imagjinative të nevojshme për të propozuar dhe punuar për alternativat e sistemit të tanishëm që Axhenda e Hagës ka treguar si të dështuar. Aftësitë për të krijuar, planifikuar, dhe për të strategjizuar sisteme alternative të sigurisë duhet që të kultivohen në edukimin e menduar për të kontribuar në çarmatim.

Vlerat që Formojnë Bazat e Edukimit për Çarmatim

Lexuesit do të venë re gjatë rishikimit të Tabelës # 7 se vlerat e sygjera këtu për edukimin për çarmatim janë ato që gjenden në edukimin tradicional për paqe që ka evoluar që prej mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Vlerat që duhen mbajtur nga qytetarë të përkushtuar për,

dhe që përpiqen për çarmatimin do të ishin, si njohuritë e duhura për arritjen e çarmatimit, shuma integrale e vlerave të mbrojtura në qëllimet e vendosura në bazat e tjera. Përkushtimi në mos përdorimin e dhunës ka frymëzuar shumë vetë që të punojnë për çarmatimin. Respekti për të drejtat e të tjerëve ka drejtuar shumë që të mos pranojnë përdorimin e armëve për të arritur qëllime sociale e politike. Respekti për jetën ka mundësuar njerëzit që të kuptojnë ndërlidhjet dhe t'u përqasen detyrave të paqebërjes në forma bashkëpunimi dyanësisht rritëse. Përgjegjësia shoqërore ka sjellë shumë njerëz në lëvizjet ndërkombëtare për paqe e drejtësi, që përbëjnë shoqërinë civile botërore.

Në të vërtetë, është përkushtimi për të ndihmuar përgatitjen e studentëve për të marrë pjesë në këto lëvizje që ka çuar Fushatën Botërore për Edukimin për Paqe në prodhimin e këtij burimi për të cilin ne kemi propozuar këto qëllime edukimore. Është shpresa jonë se ky projekt do të prodhojë mundësi të tjera programesh për edukimin për çarmatim.

Sygjerime për Lexime:

- ◆ ***Global Action to Prevent War (Aksioni Botëror për Ndalimin e Luftës);*** Projekti për Modelin e Rendit Botëror; shiko www.globalactionpw.org
- ◆ ***Disarmament Education (Edukimi për Çarmatim);*** Raporti dhe dokumenti final për Kongresin Botëror mbi Edukimin për Çarmatimit. Paris: UNESCO, 1980
- ◆ ***Dismarming: Discourse on Violence and Peace (Çarmatosja: Diskutim mbi Dhunën dhe Paqen);*** Magnus Haavelsrud, Ed., Tromso, Norvegji, 1993.

METODAT: PEDAGOGJIA E
PËRFSHIRJES DEMOKRATIKE

KAPITULLI 4

“SHEKULLI I NJËZETË pa zëvendësimin e formave autoritare të qeverisjes nga qeverisja demokratike dhe rolin në rritje të shoqërisë civile në çështjet e njerëzimit.”

◆ Axhenda e Hagës, Preambula, f.2

Kapitulli 4 Metodatat: Pedagogjia e Përfshirjes Demokratike

Proceset Mësimore Pjesëmarrëse

Edukimi për qytatari botërore në një kulturë paqeje kërkon një pedagogji të përfshirjes demokratike. Përfshirja aktive dhe pjesëmarrëse e studentëve në proceset mësimore të nisura nga programet për paqen është pedagogjia më e rëndësishme dhe efektive për të përgatitur studentët për pjesëmarrje aktive në procesin botëror të ndryshimit që po çohet përpara nga shoqëria civile mbarëbotërore. Në këtë kapitull, ne ofrojmë disa sygjerrime mbi metodat mësimore të rëndësishme për një pedagogji të përfshirjes demokratike. Ne fillojmë me një adaptim të disa sygjerrimeve të përgatitura për përdorim në një standart mësimor jo formal për të rriturit. Ne shohim se këto sygjerrime përmbledhin shumicën e atyre që ne do të shprehim për një klasë të një shkolle të mesme ku diskutimi reflektiv është bërthama e procesit mësimor.

Disa Udhëzime për Lehtësimin e Diskutimeve në Klasë (Adaptuar nga *Këmbanat e Paqes* nga Richard Claude, për Dekadën Njerëzore për të Drejtat e Njeriut, 1999). Këto udhëzime marrin si të mirëqenë faktin se studentëve u është dhënë për lexim material i përgjithshëm apo kanë bërë kërkime mbi temën e diskutimeve.

1. Jini shumë të qartë për faktin se roli i mësuesit është të lehtësojë diskutimin mes studentëve, kështu që të gjithë mund të ndajnë njohuritë dhe mendimet e tyre mbi temën dhe të mësojnë nga njëri tjetri.
2. Jini të sigurtë që studentët të njohin të gjithë emrin e njëri tjetrit, dhe ti drejtohen njëri tjetrit me respekt.
3. Rishikoni subjektin dhe qëllimin e diskutimit dhe ato që ju prisni që studentët të mësojnë prej tyre. Bëni disa pyetje për të siguruar që studentët kanë njohuri të mjaftueshme të subjektit për një diskutim të informuar.
4. Paraqisni temën e çdo diskutimi, duke ofruar përkufizime e informacion të përgjithshëm, dhe vëreni njohurinë e mëpareshme të studentit mbi temën dhe gjithashtu atë që ata kanë mësuar nga leximi dhe/ose kërkimi. Përpiquni që të lidhni temën me problemet dhe pritshmëritë e studentëve.
5. Merrni eksperiencat e studentëve në lidhje me temën e diskutimit apo me aktivitetin mësimor.
6. Shpjegoni përafërsisht sa sa kohe keni, dhe lini kohë të mjaftueshme për diskutime.
7. Paraqisni idetë dhe pyetjet që do merren në konsideratë, duke nxjerrë pikëpamje të ndryshme mbi këto çështje. Jini të sigurtë që ti lini mundësi studentëve të flasin për eksperiencat e tyre. I ndihmoni ata të qartësojnë rëndësinë e eksperiencës dhe njohurinë e temës.
8. Sjellja dhe perceptimi i mësuesit janë të rëndësishëm. Dëgjoni me kujdes të gjithë nxënësit. Jini të vëmendshëm edhe për sjelljet, perceptimet, dhe ndërveprimin midis studentëve. Kujdesuni që ata të trajtojnë me respekt njëri tjetrin, duke përdorur kontributin e të gjithëve. Sigurohuni që të gjithë studentë t'ju mund t'ju dëgjojnë juve dhe njëri tjetrin.
9. Kini kujdes në përjasjen dhe përfshirjen e të gjithë studentëve, për shembull, mos thërrisni emrin e dikujt gjatë gjithë kohës, më mirë punoni për pjesëmarrjen e të

gjithëve. (Nganjëherë puna në grup mund të jetë mënyra më efektive për të siguruar pjesëmarrjen).

10. Evitoni shkëmbimet argumentuese. Gjithësesi, lejoni dhe inkurajoni ndryshimet në opinione, të shprehura me respekt, me diferencat të trajtuara si pika interesi dhe mundësi për të mësuar, dhe jo si baza për konflikt dhe mundësi për të shprehur njohuri superiore apo aftësi.
11. Mos i lejoni studentët që të ndërpresin njëri tjetrin. Përpiquni që të mbani një ekuilibër midis lejitimit të diskutimeve të plota dhe dominimit të diskutimit prej një pakice. Kujdesuni që koha të racionohet në mënyrë që të gjithë të shprehin idetë e tyre.
12. Jepuni studentëve kohë të përshtatshme për të menduar dhe për të shpjeguar atë që ata mendojnë. I inkurajoni ata që të japin shembuj konkretë të koncepteve dhe ideve. Kujtohuni që ta bëni edhe vetë këtë gjë.
13. Shpjegoni dhe përmbliidhni shkurtimisht kur është e nevojshme, për shembull, me fjalët e vështira apo konceptet.
14. Kontrolloni që të siguroheni se studentët e kuptojnë plotësisht diskutimin, dhe gjithmonë lejoni pyetje dhe sqarime të mëtejshme.
15. Gjithmonë përmbliidhni pikat themelore, duke rforcuar konceptet dhe informacionin e nevojshëm për të kuptuar kontekstin e diskutimeve, dhe studimin e mëtejshëm të temave që janë të lidhura me temën në diskutim.

Përfaqse Mësimore të Dobishme për një Pedagogji të Përfshirjes

The Bells of Freedom (Këmbanat e lirisë), (Claude, 1999) ofron gjithashtu një sërë metodash të tjera që lehtësojnë pjesëmarrjen, mësimin, dhe përfshirjen kritike rreth çështjeve të lidhura me paqen dhe drejtësinë. Këto përfshijnë si vijojnë:

(Stuhinë e ideve) Brainstorm: marrja e ideve apo propozimeve të çastit, pa i mbrojtur apo pa i dhënë prioritetë atyre menjëherë. Pastaj hapet një diskutim mbi pranueshmërinë apo vlefshmërinë e ideve dhe propozimeve të sygjera.

Çiftet (Dyads): çdo student/e kthehet nga studenti/studentja që ka pranë (nga e majta ose e djathta), dhe kokë më kokë bëjnë një diskutim të shkurtër. Kjo është një mënyrë për të filluar marrjen në konsideratë të alternativave të shumëfishta, që janë pjesë përbërëse e shumë prej proceseve të mësimin të inkurajuara në edukimin për paqe, dhe një format i dobishëm për praktikimin e aftësive të të dëgjuarit.

Rasti Studimor (Case Study): një informacion i shkurtër apo një skenar apo një përshkrim se si, për shembull një problem që ka lindur në të shkuarën, është trajtuar dhe është zgjidhur. Mund të jetë një shembull historik apo hipotetik, por duhet që të lidhet me eksperiencat e tanishme të nxënësve si dhe me temën e studimit.

Pluskimi (Floating): kur studentët formojnë grupe të vogla për diskutim, mësuesi lëviz rreth e rrotull (pluskon) në një mënyrë të qetë sa nga njëri grup tek tjetri duke vlerësuar procesin mësimor, duke kërkuar sigurinë që çdokush është i qartë në lidhje me pyetjet dhe duke i kujtuar atyre se sa kohë kanë për të kompletuar detyrat e veçanta mësimore.

Rrotullamet (Go arounds): të gjithë studentët kanë rastin të flasin pa ndërprerje, njëri pas tjetrit, për shembull, duke e marrë me rradhë grupin pa lënë asnjërin jashtë. Kjo bëhet shumë më mirë në grupe të vogla, por kur e lejon koha mund të përfshihet e tërë klasa.

Akullthyesi (Icebreaker): një aktivitet, zakonisht në fillim të një klase të re apo teme studime për ti bërë studentët pozitivisht të përfshirë në procesin e ri mësimor dhe për të ndërtuar një atmosferë komuniteti mes tyre. Ata mund të shkëmbejnë ide për çfarë shpresojnë se do të mësojnë në klasë apo rreth çështjes në fjalë.

Luajtja e Roleve (Role Play): studentët marrin “pjesë në veprim” duke ndërmarrë një rol të veçantë, duke demonstruar një pozicion apo një çështje, për shembull, luajtja e roleve dhe diskutimi nga pozicioni i një mbrojtësi të çarmatimit apo të sigurisë së armatosur, apo të një drejtuesi ndërmarrjeje apo personi të marxhinalizuar nga globalizimi.

Raportimi (Reporting Back): kur studentët formojnë grupe të vegjël, një person duhet të raportojë tek grupi i madh konkluzionet e diskutimeve të grupit të vogël apo vendimet e marra pas diskutimeve të grupeve të vogla. Përsëritja e përmbajtjeve të diskutimeve nuk është e dobishme, përveçse kur një pjesë e tyre nevojiten për të qartësuar konkluzionet. Mësuesit duhet ta

kenë të qarte se, në pjesën më të madhe, janë vetëm konkluzionet dhe vendimet ato që duhet të raportohen.

Të Folurit nga Eksperienca: njëri prej studentëve flet rreth eksperiencave personale për një çështje apo problem që po diskutohet. Mësuesi i inkurajon të tjerët të veprojnë po kështu, por duhet të jetë i ndjeshëm ndaj atyre që nuk ndjehen mirë dhe nuk dëshirojnë të tregojnë rreth çështjeve personale apo eksperiencave individuale.

Rrethi folës (Talking circle): të gjithë studentët i rregullojnë karriget e tyre apo ulen në mënyrë që të formojnë një rreth në mënyrë që çdo pjesëmarrës të shohë në fytyrë të tjerët. Ky rregullim ndihmon që të gjithë të jenë të vëmendshëm ndaj njëri tjetrit dhe i inkurajon të gjithë që të marrin pjesë në diskutim.

Metoda dhe Teknika të Mësimimit të Paqes

Paraqitja e mundësive për pjesëmarrje dhe përfshirje aktive të studentëve është thelbësore për metodat e edukimit për paqe. Teknikat e mëposhtme, të adaptuara nga puna kolosale e Dekadës së Njerëzve për Edukimin e të Drejtave të Njeriut dhe të vendosura në *Këmbanat e lirisë* (Claude, 1999) janë disa sygjjerime të dobishme.

Rrotat e fjalëve: studentët qëndrojnë në dy rrathë me numra të barabartë, njëri brenda tjetrit në mënyrë që çdo student në rrethin e brendshëm të këtë përballë dikë në rrethin e jashtëm, për të ndarë një ide apo për të prezantuar një fakt në lidhje me temën që po diskutohet. Rrota mund të rrotullohet (majtas apo djathtas) në mënyrë që çdo student të këtë folur kokë më kokë me secilin nga pjesëmarrësit. Në këtë mënyrë çdo anëtar i klasës ka folur me të tjerët. Duke e përsëritur këtë gjë me raste, arrihet që të gjithë antarët e klasës të komunikojnë me të gjithë të tjerët. Kjo gjithashtu mund të kombinohet me ushtrime afirmuese për të ndërtuar unitetin e komunitetit apo grupit, që do të shërbejë për një ambient mësimor të pëlqyeshëm dhe konstruktiv.

Vendosja e pritshmërive: ky ushtrim është i dobishëm në fillim të një klase, teme studimore, apo ushtrimi mësimor. Mësuesi fillon procesin mësimor duke paraqitur subjektin e çështjes si dhe qëllimin e studimit apo ushtrimit. Në lidhje me këtë, mësuesi i kërkon nxënësve që të shprehin aspektativat (pritshmëritë) e tyre në lidhje me mësimin mbi subjektin e çështjes që është identifikuar, dhe i inkurajon ata që të vendosin qëllime mësimore për veten e tyre, duke u kujtuar se mund të këtë shumë qëllime të ndryshme dhe se studentët mund të ndihmojnë njëri tjetrin për

të arritur qëllimet respektive të secilit. Mësuesi duhet ti inkurajojë nxënësit që të flasin lirisht por shkurtimisht dhe ti sigurojë ata që nuk ka “përgjigje” apo “pritshmëri” të gabuara. Pasi i ka dëgjuar me vëmendje të gjithë, mësuesi duhet të përmbledhë shkurtimisht pritshmëritë e përgjithshme në lidhje me temën që do të studiohet dhe qëllimet e përgjithshme mësimore të krijuara me zgjedhjen e temës.

Mbajtja e ditarëve: studentët duhet që të inkurajohen që të mbajnë ditarë në të cilët ata ruajnë objektivat e përgjithshëm të klasës dhe qëllimet e tyre personale. Ditarët mund të përdoren për të ruajtur atë që ata po mësojnë, për të vlerësuar progresin drejt objektivit të klasës dhe qëllimeve të tyre mësimore, dhe për të reflektuar rreth atyre çështjeve të ngritura në diskutimet në klasë. Këto reflektime mund ti tregohen edhe klasës.

Vlerësimi i mësimi: Ky mjet është një alternativë e provimit tradicional. Studentët shkruajnë një ese duke përmbledhur mësimet kryesore të arritura në klasë apo në njësinë e studimit. Ata tregojnë se përse mësimi është i rëndësishëm, se si ata mendojnë se kanë mësuar dhe se si ka ndikuar ky mësim në mënyrën se si ata i shohin problemet apo çështjet e diskutuara si dhe çështje të tjera. Ata gjithashtu duhet të tregojnë se sa afër shkuan ata dhe klasa në arritjen e qëllimeve mësimore dhe se çfarë mësimi shtesë rreth temës mund që të ndjekin. Mësuesit duhet ti përgjigjen këtyre vlerësimeve me komente për të inkurajuar studentët, të ngrenë çështje për reflektime të mëtejshme dhe nëse është e nevojshme, të vendosin pyetje apo punë të mëtejshme për të siguruar që studentët kanë arritur ashtu siç duhet qëllimet e mësuesit dhe ato të klasës.

Mësimi i përbashkët: shumë edukatorë të paqes tani përdorin forma të ndryshme të mësimi të përbashkët në të cilët studentët ndajnë detyra të veçanta mësimore për të arritur një qëllim mësimor të grupit. Detyrat mësimore bëhen në një mënyrë që më mirë i shkon qëllimeve të përbashkëta ndërsa i lejon studentët të ndjekin disa prej interesave të tyre. Mësimi i përbashkët bën secilin të aftë që të përdorë pikat e tija të forta mësimore ndërsa ndihmon të tjerët të zhvillojnë pikat e tyre të forta dhe ndihmon të gjithë që të arrijnë përtej kufizimeve të tyre të perceptuara. Këto teknika inkurajojnë vlerat e bashkëpunimit dhe komunitetit dhe shërbejnë si kundërpesha të klasave tradicionale konkurruese të cilat duken si kontribues për mungesën e kujdesjes dhe respektit për të tjerët.

Simulimet: lojrat e ndërtuara me kujdes që përfshijnë luajtjen e roleve, skenarët dhe përshkrimet e sistemeve, organizatave dhe strukturave, si për shembull sistemi ekonomik mbarëbotëror,

Kombet e Bashkuara apo rregullimet e traktateve. Simulimet i bëjnë nxënësit të aftë të mësojnë se si funksionojnë këto sisteme, të vlerësojnë fuqitë dhe dobësitë e tyre, dhe të konsiderojnë alternativat. Për shembull, një simulim i sistemit të sigurisë botërore të shteteve të armatosura mund të simulohet dhe të vlerësohet në krahasim me alternativat e propozuara si ato të propozuara nga Veprimi Global për Ndalimin e Luftës, i shpallur nga **Axhenda e Hagës**.

Analiza e vlerave: duke qenë se edukimi për paqen është i bazuar në vlera, është e rëndësishme që vlerat e përfshira në të gjitha çështjet dhe pozicionet për këto çështje të ekzaminohen me kujdes. Studentët duhet që të inkurajohen për të eksploruar në mënyrë kritike vlerat e komuniteteve dhe shoqërive të tyre dhe të jenë plotësisht në dijeni të vlerave të tyre.

Strategji Mësimore të Sygjeruara nga Edukatorët Ndërkombëtare për Paqen

Pyetjet mbi metodat e mësimin dhe përjasjet janë diskutuar nga Grupi Ndërkombëtar Keshillimor i Fushatës Mbarëbotërore për Edukimin për Paqe. Ato që vijojnë janë disa prej sygjërimeve të tyre që i shkojnë më për shtat një pedagogjije të përfshirjes dhe zhvillimit të krijimtarisë së nevojshme për të planifikuar dhe për të punuar për një transformim global drejt kulturës së paqes.

Tregimi i historive: tregimi i eksperiencave të përpjekjeve individuale dhe në grup për të arritur shoqëri më humane mund tu japë studentëve bazën për një shpresë për paqe.

Heronjtë e paqes: identifikimi dhe përshkrimi i karakteristikave të heronjve të paqes bëjnë të mundur për studentët kuptimin e natyrës së përkushtimit për veprimin dhe përgjegjësinë shoqërore të nevojshme për veprim të efektshëm për paqe.

Artet: duke përdorur poezinë, muzikën, dramën, pikturën dhe arte të tjera plastike studentët bëhen të aftë të shprehin shqetësimet dhe idetë në mënyra që stimulojnë imagjinimin e kapaciteteve dhe krijimin e aftësive të tjera, të ndryshme nga ato që theksohen zakonisht në programet akademike.

Të ardhmet e preferuara: duke zhvilluar imazhe të shoqërive paqësore drejt të cilave ata synojnë të shkojnë studentët frymëzohen që të ndër marrin veprime për të influencuar në të ardhmen dhe për të ndihmuar në krijimin e asaj lloj bote në të cilën ata do të duan të jetojnë dhe të lenë pas për fëmijët e tyre.

Praktikimi i aftësive

Shumë mundësi duhet të paraqiten në klasat e edukimit për paqe për të praktikuar aftësitë e lidhura me qytetarinë e përgjegjshme. Disa nga më të rëndësishmet e këtyre aftësive janë: diskutimi publik i hapur e konstruktiv mbi çështjet kritike; kuptimi i plotë i pozicionit të të tjerëve; dhe marrja e perspektivave të shumëfishta për të shikuar pozicionet alternative dhe/ose konfliktuale. Ashtu siç është sygjëruar në *Këmbanat e lirisë*, (Claude 1999), ushtrimet për diskutimin, dëgjimin, dhe luajtjen e roleve mund të ndihmojnë mprehtësimin e këtyre aftësive. Seksioni në vazhdim përshkruan këto aktivitete.

USHTRIM DISKUTIMI

Diskutimi mund të jetë shumë jo-zyrtar dhe bisedimor, ose mund të jetë goxha i strukturuar. Në një diskutim shumë të strukturuar, qëllimi i ushtrimit është që studentët të praktikojnë shprehjen dhe mbështetjen për një pikëpamje dhe pastaj, pasi të kenë dëgjuar atë që të tjerët kanë për të thënë, të ndryshojnë, rregullojnë, apo afirmojnë pozicionet e tyre. I përshkruar më poshtë është një shembull i procesit të diskutimit.

(1) Ndani studentët nëpër grupe me numër të barabartë pjesëmarrësish në bazë të pozicioneve të ndryshme mbi çështjen që lidhet me temën e studimit. Vendosini grupet përballë njëri tjetrit. **(2)** Kërkojini secilit grup që të marrë një pozicion në diskutim, për shembull, një grup do të mbrojë idenë se mundësia e pasjes ujë të rrjedhshëm të pastër është një e drejtë e njeriut, një grup tjetër do të mbrojë idenë se kjo mund të jetë një politikë e dëshirueshme por jo një e drejtë e njeriut, dhe një grup i tretë do të mbrojë idenë se është një nevojë që duhet plotësuar për mbijetesën e kujtdo popullsie urbane, pamvarësisht nëse është apo jo një e drejtë e njeriut. Këto janë grupe të dhëna nga mësuesit, prandaj nxënësve mund t'ju duhet të mbrojnë një argument me të cilin ata nuk janë dakort personalisht. **(3)** Jepini secilit grup kohë për të përgatitur argumentat e tyre. Çdo student në grup duhet të përgatisë një argument për të mbështetur pozicionin e grupit. Kjo bëhet me qëllim, sepse, kur të vije koha për të diskutuar çështjen me grupet e tjera, çdo person të ketë vetëm një shans për të folur. **(4)** Kur skuadrat janë gati, të gjithë grupet do të ulen përseri përballë njëri tjetrit. Çdo grup ka shansin të jap një argument, duke nisur me skuadrën që është në favor të idesë se aksesit tek uji është e drejtë e njeriut. Pastaj vazhdohet duke i dhënë çdo skuadre mundësinë të prezantojë derisa gjithkush të ketë pasur mundësinë për të folur. Kur kjo të mbarojë atëherë i thoni studentëve të lëvizin në një grup nëse ata dëshirojnë të mbështesin atë pikëpamje. Kështu ata do të shkojnë tek pozicioni që ata në fakt mbështesin. Mund të krijohet edhe një grup tjetër me ata që janë të pavendosur. Nxirrni konkluzionet dhe mbyllni ushtrimin duke i pyetur studentët që ndryshuan pozicion për argumentat që i bënë ata të ndryshonin mendim. I kërkonit atyre që të tregojnë se çfarë mësuat nga ushtrimi.

USHTRIM DËGJIMI

Qëllimi i këtij ushtrimi është të inkurajojë nxënësit që të dëgjojnë pozicionet e të tjerëve dhe të mësojnë se si të përmbledhin pikat e rëndësishme në një kohë të shkurtër. Kjo mund të bëhet shumë thjesht duke i kërkuar çdo student që jep një ide që të fillojë me një përmbledhje të shkurtër të pozicionit të parafolësit. Një metodë alternative, pak më komplekse përshkruhet pak më poshtë.

(1) Ndani klasën nëpër grupe të vegjël, për shembull, me 3 apo 4 persona. **(2)** Kërkojini secilit grup që të marrë një pozicion në diskutim, me një numër të barabartë për çdo pozicion. Për shembull, A ka detyrë të mbrojë idenë se të drejtat e njeriut për gratë kërkojnë që aktet e dhunës në familje nga burri të trajtohen si krime dhe të jenë subjekt hetimi për policinë, ndërsa B do të argumentojë se këto veprime janë çështje private dhe nuk duhet që ti raportohen policisë. C do të argumentojë se gjithë shkallet e shunës janë shqetësim për komunitetin, dhe ndalesat shoqërore për dhunën në familje duhet të jenë subjekt i ndërhyrjes së komunitetit. **(3)** Një person nga grupi A shkurtimisht jep argumentin e parë për një zgjidhje publike të dhunimit të të drejtave të grave. **(4)** Dikush nga pozicioni B fillimisht duhet të përmbledhë shkurtimisht argumentin e A, dhe pastaj të paraqesë argumentin e parë nga pozicioni B. **(5)** Dikush nga pozicioni C përmbledh atë që tha B dhe pastaj prezanton argumentin e tij apo të saj. A përmbledh pikëpamjen e C dhe vazhdon me argumentin e tij pasardhës. Ky ushtrim vazhdon në të njëjtën mënyrë derisa të gjithë argumentat të jenë prezantuar. Pastaj studentët rishikojnë procesin, veçanërisht se sa mirë secili ka arritur të përmbledhë dhe të prezantojë pozicionin e të tjerëve. Praktikimi i dëgjimit duhet të ndihmojë në zhvillimin e këtyre aftësive.

USHTRIM PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE

Ky ushtrim është i dobishëm si një “përmbledhës” për shumicën e njësive mësimore apo çështjet e problemeve, dhe mund të konsistojë thjesht në identifikimin e sa më shumë zgjidhjeve që grupi mund të imagjinojë dhe pastaj të vlerësohen ato sipas kriterëve të të drejtave të njeriut dhe paqes dhe të vendosen ato sipas prioriteteve. Një metodë më komplekse për zgjidhjen praktike të problemeve është që një grup studentësh të krijojë një përjasje hap-pas-hapi për një problem, dhe të shkruajë përjasjen apo të kenë një vullnetar që e raporton këtë përpara klasës.

Një aktivitet interesant për zgjidhjen e problemeve përfshin krahasimin e përjasjeve të ndryshme. **(1)** Filloni duke i kërkuar klasës të bjerë dakort mbi një sërë kriteresh të bazuara në parimet e të drejtave të njeriut, paqes dhe drejtësisë, që do të përdoren në vlerësimin e zgjidhjeve të propozuara për problemet. **(2)** I ndani studentët në dy apo më shumë grupe, dhe jepini secilit të njëjtin problem, për shembull, të përgatisin rekomandimet për pushtetin e tyre lokal rreth një problemi të komunitetit në lidhje me paqen apo drejtësinë. **(3)** Jepini grupeve kohë të mjaftueshme të punojnë me përjasjet e tyre. **(4)** Bëni raportimin e përjasjeve. **(5)** Hapni një diskutim të përgjithshëm rreth faktit se cila nga përjasjet është më e përshtatshme dhe më konsistente me parimet e paqes dhe drejtësisë. **(6)** Zgjidhni një përjasje të cilën të gjithë e besojnë si potencialisht më të efektshmen. **(7)** Planifikoni një strategji hap-pas-hapi për të arritur qëllimet e përjasjes së preferuar.

USHTRIM PËR LOJËN E ROLEVE

Loja e roleve mund të nxjerrë në pah çështjet në një mënyrë të pëlqyeshme dhe të ndihmojë studentët që të kuptojnë perspektiva të ndryshme. Në një lojë rolesh, pjesëmarrësit veprojnë pa ndonjë praktikim të mëparshëm. E thënë ndryshe, ata bëhen pjesë e aksionit, dhe qëllimi i ushtrimit është që të vlerësojë përgjigjen e tyre kur ata hidhen në situata të rastit. Çdo lojë rolesh duhet të paraprihet nga shpërndarja e përshkrimeve të identitetit dhe pozicionit të rolit.

Një lojë rolesh e thjeshtë mund të fillojë me një pyetje të mësuesit: kush ka qenë dëshmitar i një incidenti të abuzimit të të drejtave të njeriut? Atyre që luajnë rolet e viktimave apo dëshmitarëve më vonë mund t'ju kërkohet, ndoshta me ndihmën e një "aktori" tjetër (oficeri i policisë) që të ribëjnë aksidentin me ndjenja (1) Në çdo lojë rolesh emocionale, mësuesi duhet të shpjegojë qartësisht së çfarë do të ndodhi përpara se të fillojë loja, dhe ti kërkojë studentëve bashkëpunimin e tyre. (2) Loja e roleve duhet bërë ngadalë. Nëse është shumë e nxituar dhe gjithëkush flet në të njëjtën kohë, studentët mund të bëhen konfuz dhe të mos mësojnë shumë nga loja e roleve. (3) pasi problemi është luajtur, fillojnë diskutimet në klasë për të vlerësuar nëse nxënësit mendojnë se ka çështje të të drejtave të njeriut apo paqes të përfshira. (4) Pyesni klasën se si duhet të trajtohet problemi, duke marrë parasysh kriteret e të drejtave të njeriut dhe të paqes. (5) Pas këtij diskutimi, u ndërroni vendin aktorëve dhe luajeni skenarin përsëri. Në diskutimin që vijon, pyesni aktorët që t'ju tregojnë se çfarë perspektivash dhe pikëpamjesh të reja arritën ata me ndërrimin e roleve dhe pozicioneve. (6) Skenarët me shumë aktorë dhe pozicione duhet të prezantohen së fundmi për të demonstruar një sërë më të gjerë perspektivash e pikëpamjesh.

PËRMBLEDHJA

Hapi i fundit dhe më thelbësori në të gjitha metodat pjesëmarrëse është “përmbledhja” në të cilën mësuesi përmbledh zonat kryesore konceptuale që janë eksploruar dhe inkurajon studentët që të reflektojnë mbi mësimin e tyre dhe se si ndikohen pikëpamjet e tyre mbi subjektin dhe çështjet më të mëdhaja të paqes dhe drejtësisë.

Si përmbledhja, një pedagogji përfshirjeje i fut studentët në procese pjesëmarrëse mësimi, të përshtatura për fazat e tyre të zhvillimit. Që prej fazave më të hershme zhvillimore të pedagogjisë së paqes, duhet inkurajuar marrja e perspektivave të shumëfishta mbi gjithë pyetjet që ngrihen në klasë nga lidhjet ndërpersonale deri tek çështjet mbarëbotërore. Në ndërmarrjen e veprimeve apo vendosjen e zgjidhjeve, të gjitha alternativat e mundëshme duhet që të merren në konsideratë ndërsa studentët drejtohen për të zhvilluar kapacitetin kritik për të bërë zgjedhjet në dritën e vlerave plotësisht të ekzaminuara.

Metodat e veçanta të rradhitura këtu janë një zgjedhje midis shumë të tjerave që ne i mendojmë si më thelbësoret për edukimin për paqe për përgjegjesi civile mbarëbotërore. Ato përshkruhen për nxënësit adoleshentë dhe të rinj. Sidoqoftë, të gjitha këto teknika mund tu adaptohen edhe nxënësve më të rinj. Teknikat e reja për mësimin drejt të njëjtave qëllime mund dhe duhet të krijohen.

Mënyrat pjesëmarrëse të mësimin janë gjithashtu esenciale, siç neve themi në kapitullin vijues, për edukimin e mësuesve. Mësuesit që kanë për të përdorur këto metoda kanë nevojë që të kenë vetë eksperiencë mësimore nëpërmjet tyre.